


RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

PROGRAMI I STUDIMIT:



Bachelor në Shkenca Komunikimi

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR



KOLEGJI
UNIVERSITAR
BEDËR



RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK
Për Programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi
Kolegji Universitar Bedër

JANAR 2019


Tiranë, Shqipëri

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	3
HYRJE	4
RRETH KOLEGJIT UNIVERSITAR “BEDËR”	4
RRETH PROGRAMIT TË STUDIMIT “BACHELOR” NË SHKENCA KOMUNIKIMI	5
GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)	7
PARIMET E PUNËS SË GVB	7
ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA IAL	7
ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË	8
I. REKOMANDIMET E BORDIT TË AKREDITIMIT	8
II. PLOTËSIMI I TYRE NGA INSTITUCIONI	8
PROGRAMI/ET E STUDIMEVE, MISIONI, ADMINISTRIMI	10
1. MISIONI DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT	10
2. STRUKTURA AKADEMIKE E FAKULTETIT DHE DEPARTAMENTIT TË KOMUNIKIMIT	15
PROCEDURA E APLIKIMIT DHE E MARRJES NË PUNË TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË	30
INFRASTRUKTURA NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT, LOGJISTIKA DHE SHËRBIME TË TJERA NDAJ KOMUNITETIT	40
FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE	45
SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË, NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT	48
KOMPETENCAT E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË JANË:	48
POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE	54
PROGRAMI I STUDIMIT, ORGANIZIMI I TIJ	54
MËSIMDHËNIA	72
AKTIVITETE MBËSHTETËSE TË PROCESIT MËSIMOR	73
STUDENTËT	77
PROCEDURAT E PRANIMIT TË STUDENTËVE.....	78
KUSHTE SPECIFIKE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE	78
KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT	86
KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.....	86
<i>Politikat e kërkimit shkencor</i>	86
<i>Informacion për ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien</i>	86
KONFERENCA DHE WORKSHOPE	87
TË DHËNA PËR KËRKIMIN SHKENCOR TË PERSONELIT AKADEMIK, PËRGJEGJËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT	90
BASHKËPUNIMI KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	98
ANALIZA PËRMbledhëse PËR VLERËSIMITIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT	105
ANALIZA PËRMbledhëse PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË.....	105
.....	105
ANALIZA PËRMbledhëse E RVB SIPAS METODËS SWOT	105
LISTA E EVIDENCAVE	108

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 - Këshilli i Departamentit.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 2: Personeli akademik për çdo njësi bazë	21
Tabela 3: Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i departamenteve	23
Tabela 4: Personeli drejtues, mësimdhënës dhe ndihmës akademik për programin e studimit sipas viteve	31
Tabela 5: Personeli akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre sipas viteve	34
Tabela 6: Personeli akademik PAE sipas moshës.....	35
Tabela 7: Personeli akademik PAK sipas moshës	35
Tabela 8: Mjediset për fakultetet dhe KUB	41
Tabela 9: Mjediset për personelin.....	41
Tabela 10: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit	45
Tabela 11: Shpenzimet në 6 vitet e fundit	45
Tabela 12: Anëtarët e NJBSC.....	49
Tabela 13: Plani mësimor Viti I.....	56
Tabela 14: Plani mësimor Viti II	57
Tabela 15: Plani mësimor Viti III	58
Tabela 16: Plani mësimor sipas veprimtarive formuese	59
Tabela 17: Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programin e licensuar.....	60
Tabela 18: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik sipas viteve	60
Tabela 19: Shembull syllabus lënde	68
Tabela 20: Aktivitete të realizuara nga e me përfshirjen e studentëve gjatë periudhës akademike 2013-2018..	74
Tabela 21: Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies	76
Tabela 22: Shembull për format e kontrollit të njohurive.....	76
Tabela 23: Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë.....	76
Tabela 24: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve	80
Tabela 25: Të dhëna për punësimin e studentëve	81
Tabela 26: Aktivitete shkencore personelit të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në 6 vitet e fundit.....	90
Tabela 27: Publikime dhe Projekte të Personelit (2014-2018)	90
Tabela 28: Konferenca Studentore	96
Tabela 29: Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në 6 vitet e fundit.....	98
Tabela 30: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	98



RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK
Për Programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi

HYRJE

Rreth Kolegjit Universitar “Bedër”

Kolegji Universitar “Bedër” (KUB) u çel me vendimin nr.286, datë 6.4.2011 të Këshillit të Ministrave¹, me anë të të cilit u miratua dhënia e licencës për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë. KUB është një institucion në fushën e arsimit të lartë, i cili funksionon si organizatë jofitimprurëse. Akreditimi i parë institucional në vitin 2013 nga APAAL², rikonfirmimi i këtij vlerësimi nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL në vitin 2017³, por edhe i të gjitha programeve të studimit që ofrohen, është një tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe standardeve të Kolegjit Universitar “Bedër” .

KUB synon rritjen e cilësisë akademike dhe institucionale, e cila i ka përcaktuar vizionin e funksionimit, që nuk synon masivitetin, por cilësinë. Kapaciteti studentor maksimal afatmesëm i parashikuar i kolegjit universitar është 1250-1500 studentë në të gjitha programet, për nivelet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë (bachelor, master).

KUB ka vendosur si synim të tij krijimin dhe konsolidimin e një profili ndërkombëtar. Në këtë këndvështrim, gjatë shtatë viteve të aktivitetit të tij, institucioni ka mundur pranimin e studentëve nga trevat shqipfolëse në rajon dhe në diasporë, si edhe nga disa vende të Evropës dhe më gjerë.

Harta e shteteve nga ku kanë ardhur studentët është zgjeruar vazhdimisht përgjatë shtatë viteve duke kapur shifrën 16 (gjashtëmbëdhjetë). Përbërja e personelit akademik, pasqyron gjithashtu profilin ndërkombëtar të kolegjit, i cili përforcohet me bashkëpunimet e vendosura nëpërmjet marrëveshjeve me universitete dhe kompani në disa vende të botës.

KUB operon mbi baza jofitimprurëse dhe mbështet studentët e suksesshëm, të cilët duan të vazhdojnë studimet e larta pranë tij. Gjatë 6 viteve të fundit të aktivitetit të tij në Kolegjin Universitar “Bedër” kanë studiuar dhe vazhdojnë studimet 780 studentë që përfitojnë zbritje nga tarifat e studimit.

KUB, që nga fillimi i aktivitetit akademik, ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare të hapura, veprimtari kualifikuese e nxitëse, duke dhënë një kontribut modest në shkencë dhe shoqëri.

Për përmbushjen e misionit të tij, KUB ofron programe studimesh në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit. Programet e ofruara janë si më poshtë:

“Bachelor” në:

1. Drejtësi;
2. Shkenca komunikimi;
3. Marrëdhënie publike dhe komunikim marketing
4. Shkenca islame;
5. Gjuhë dhe letërsi turke;
6. Gjuhë dhe letërsi angleze;
7. Arsim parashkollor dhe fillor;
8. Psikologji këshillimi dhe pedagogji.
9. Teknologji informacioni dhe komunikimi


“Master i shkencave” në:

1. Drejtësi. Profilet: E drejtë penale dhe E drejtë ndërkombëtare;

¹ Evidenca nr. 1: Vendimet e KM për licensimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe të programeve akademike të ofruara

² Evidenca nr. 2: Urdhër Nr: 223, Datë 04.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”

³ Evidenca nr. 3: Vendim nr.101 datë 10 11 2017 "Për akreditimin periodik të Kolegjit Universitar "Bedër"



2. Shkenca komunikimi. Profilet: Marrëdhënie me publikun dhe Gazetari;
3. Shkenca moderne islame;
4. Shkenca themelore islame;
5. Psikologji këshillimi dhe pedagogji;
6. Gjuhë dhe letërsi turke;
7. Gjuhë dhe letërsi angleze.

“Master profesional” në:

8. Mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm;
9. Mësuesi, gjuhë turke për arsimin e mesëm.

Programet e studimit në të dyja ciklet organizohen në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga Karta e Bolonjës dhe legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë.

Aktivitetet me bazë kërkimore janë një kriter i rëndësishëm për profesionalizmin që karakterizon punën brenda KUB. Mbështetur në një filozofi të qartë mbi nivelin e arsimit që ofron, si pjesë e një fondacioni arsimor dhe me status jofitimprurës, liria akademike dhe autonomia institucionale e kolegjit ndihmojnë për të realizuar idetë e planifikuara, por nga ana tjetër, të gjitha këto janë të shoqëruara me përgjegjësi për vendimet e ndërmarra. Hapja ndaj ideve të reja, bashkëpunimi mes njerëzve, organizatave dhe fushave kërkimore, si dhe qasja me në qendër zhvillimin e vlerave humane kontribuojnë në ndryshime pozitive në kolegji dhe botën rreth tij.

Rreth Programit të Studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Kolegjin Universitar “Bedër” është njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Humane. Në përputhje me ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011⁴, “Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), të ndryshuar, si edhe akteve të tjera ligjore në fuqi në lidhje me arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, Departamenti i Shkencave të Komunikimit vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave të komunikimit, marrëdhënies me publikun e medias.

Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit parashtron arsim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar ta ndërtojnë karrierën e tyre profesionale si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, në fusha të ndryshme të përcjelljes së informacionit me anë të mjeteve të ndryshme, si edhe në fushën e marrëdhënies me publikun.⁵

Programi i studimit “Bachelor” në profilin Shkenca Komunikimi është projektuar t’u ofrojë studentëve një formim intelektual, profesional e të gjithanshëm, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e komunikimit, marrëdhënies me publikun e të medias.

Misioni

Misioni i Departamentit të Shkencave të Komunikimit është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit dhe të marrëdhënies publike dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetjen shkencore-kërkimore, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe të projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe ndjekin zhvillimet bashkëkohore në fushën e komunikimit, medias e të mbarë shoqërisë.

⁴ Evidenca nr. 1: Vendimet e KM për licensimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe të programeve akademike të ofruara

⁵ Evidenca nr. 6: Rregullore mbi Organizimin Akademik

Vizioni

Departamenti i Shkencave të Komunikimit synon të sjellë risi në mënyrën e aftësisë dhe të përgatitjes së studentëve nëpërmjet një gërshetimi të mirorganizuar të anës teorike me praktikën në kushte dhe mundësi fizike bashkëkohore.

Departamenti nëpërmjet programeve e kërkimit shkencor do të përgatisë profesionistë të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale dhe zhvillimi të shpejtë të teknologjive moderne që kanë përfshirë fushën e komunikimit e medias.

Mundësitë e punësimit

- I diplomuari mund të punojë në institucione mediatike publike e private si gazetar i medias së shkruar e vizive, përfshirë këtu gjitha zhanret e medias si dhe mediat e reja.
- I diplomuari mund të punojë në organizma, organizata, shoqata vendase dhe të huaja, të cilat operojnë në fushën e edukimit/komunikimit, të shërbimeve e të edukatës qytetare, si operator kurator i marrëdhënieve ndërkombëtare, në administratën publike e private etj.
- I diplomuari mund të punojë në organet drejtuese të medias së shkruar vizive.
- I diplomuari mund të punojë në subjekte politike, në zyrat e shtypit dhe të informimit, në zyrat e marrëdhënieve me publikun, në institucione të huaja, në organizma të huaj etj.
- I diplomuari mund të punojë në agjensi mediatike, agjensi marketingu apo agjensi PR si dhe në departamente komunikimi në kompani private vendase ose të huaja.

Rreth procesit të akreditimit

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutit të Kolegjit Universitar “Bedër”, si dhe urdhrorit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë”, nën përgjegjësinë e titullarit të njësive dhe me vendim të Senatit Akademik, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin “Bachelor” në Shkenca Komunikimi.⁶

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja ka në përbërjen e tij 6 antarë sipas një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.). Ai përfshin edhe përfaqësues të studentëve, si dhe është ngritur duke marrë parasysh edhe shpërndarjen e detyrave të secili anëtar.

Ky proces rivlerësimi i jashtëm për programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi vjen pas një përvoja akreditimi të vitit 2013, të cilin njësia bazë e kaloi me sukses. Jo vetëm kaq, por KUB ka ngritur që në fillimet e tij edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si njësi bazë e përhershme për të kontrolluar dhe për të garantuar përbushjen e standardeve në këtë drejtim. Një tjetër aspekt me rëndësi ka qenë dhe marrja e çertifikatës së cilësisë ISO 9001:2008.⁷


Duke filluar nga viti 2012, çdo njësi bazë dhe kryesore e KUB, çdo fundviti akademik, dorëzon në rektorat raportin vjetor, i cili në vetvete është një model i vlerësimit të brendshëm të njësive.⁸

Projekti i raportit të vetëvlerësimit u diskutua në njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime, të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

⁶ Evidenca nr. 8: Vendim për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm (GVB)





⁷ Evidenca nr.9: Çertifikatë ISO 9001:2008

⁸ Evidenca nr.10: Model i raportit vjetor të Departamentit të Shkencave të Komunikimit



GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)

Përbërja e GVB:

1. Edlira Mali – Kryetare 
2. Agron Tufa – Anëtar
3. Rudi Dunga – Anëtar 
4. Jola Marku – Relatore
5. Kristi Mukollari – Përfaqësues i studentëve 
6. Sonila Qazimi – Përfaqësuese e të diplomuarve 

PARIMET E PUNËS SË GVB

- Vlerësimi i cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tablo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve të studimit.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, personelet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.


ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA IAL

1. Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër” drejtuar Bordit të Akreditimit me shkresë nr. 14, datë 31.01.2017.⁹
2. Pranimi i kërkesës dhe njoftimi për trajnimin e grupit të punës mbi sistemin e menaxhimit të ASCAL.
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB) me propozim të Këshillit të Departamentit dhe miratim të Senatit Akademik, me vendimin nr. 3, datë 26.11.2018¹⁰.
4. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL-it.
5. Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit.
6. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me personelin e institucionit.
7. Dorëzimi në ASCAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bashkë me të gjithë dokumentacionin mbështetës.

Shënim: Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ngrihet nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë, pasi ky i fundit merr mendimin e organit vendimmarrës përkatës. Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB duhen patur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit, përfaqësimin në grup të sa më shumë opinioneve të njësisë duke evituar në maksimum përfshirjen në të të personave konfliktualë ose koniukturalë. Grupi, si rregull, ka në përbërje të tij 3-5 punonjës të njësisë. Ai ngrihet qëllimisht për misionin e vlerësimit (ad-hoc). Ai përcakton një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.) dhe një shpërndarje të detyrave. Është e domosdoshme që në GVB të përfshihen dhe përfaqësues të studentëve.

⁹ Evidenca nr. 11: Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër” drejtuar Bordit të akreditimit

¹⁰ Evidenca nr. 8: Vendim për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB)



ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit

- Të qenurit një Institucion i ri, sjell mungesën e përvojës dhe të traditës të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor një qëndrueshmëri dhe besueshmëri.
- Të rritet numri i personelit akademik efektiv.
- Të përshtatet fusha e studimit të personelit akademik me disiplinën përkatëse.
- Të përmirësohet programi i disiplinës Gjuhë Shqipe 1 dhe 2.
- Të sigurohen tekste bazë në disa disiplina.
- Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e Institucionit.
- Të realizohet një raport financiar për këtë program studimi.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- Për rekomandimin “*Të qenurit një Institucion i ri, sjell mungesën e përvojës dhe të traditës të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor një qëndrueshmëri dhe besueshmëri.*”, Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka marrë të gjitha masat për të krijuar një mjedis profesional dhe të besueshëm akademik, pavarësisht faktit që është pjesë e një Institucioni relativisht të ri. Duke krijuar linja bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperience me akademikë homologë në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, është mundësuar plotësimi i të gjitha nevojave si për studentët, ashtu edhe për personelin akademik. Departamenti i Shkencave të Komunikimit nëpërmjet misionit dhe vizionit të mirëpërcaktuar, si dhe dinamizmit të ekipit, ka hedhur hapat e nevojshëm drejt një njësie akademike të qëndrueshme dhe të besueshme për studentët, prindërit, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe institucionet publike dhe jopublike, me të cilat ka marrëdhënie. Kjo është e vërtetuar nëpërmjet marrëdhënieve të krijuara dhe dëshmimeve nga institucione, kompani dhe organizma të ndryshme të cilat kanë punësuar studentë të diplomuar nga ky departament.
- Për rekomandimin “*Të rritet numri i personelit akademik efektiv*”, Institucioni ka marrë masat për shtimin e numrit të pedagogëve në departament. Pranë departamentit është shtuar personel me kohë të plotë (efektiv) duke ndjekur procedurat e rekrutimit për personelin akademik. Në rastet kur ka qenë e pamundur që një profil specifik në kurrikulën e programit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi të mbulohej me personel akademik efektiv, është zgjedhur alternativa e bashkëpunimit me lektorë me kontratë. Në disa raste është ndryshuar forma e bashkëpunimit për personelin me kontratë që kontribuon cilësisht në departament, duke shkuar drejt angazhimit me kohë të plotë. Procesi i mbledhjes së interesit për personel të ri efektiv është në vazhdimësi. Në varësi të nevojave dhe cilësisë së kandidatave që do të shprehin interes, është planifikuar që departamenti të zgjerohet me personel të ri. Procedura përkatëse për punësimin e personelit akademik paraqitet në pikën 3 “Personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit”.
- Për rekomandimin “*Të përshtatet fusha e studimit të personelit akademik me disiplinën përkatëse*”, pas analizimit të fushave të studimit të personelit akademik dhe lëndëve që ligjërojnë, Institucioni ka marrë masat e rishpërndarjes së ngarkesës mësimore sipas ekspertizës së secilit anëtar të personelit. Departamenti vlerëson në mënyrë periodike reagimin e ardhur nga studentët për sa i përket nivelit të lektorëve dhe shkallën e vlerësimit të tyre. Aktualisht, shpërndarja e lëndëve për lektorët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit është përshtatur me fushat e ekspertizës së personelit akademik.
- Për rekomandimin “*Të përmirësohet programi i disiplinës Gjuhë Shqipe 1 dhe 2*”, është rishikuar syllabusi (programi) i lëndës Gjuhë Shqipe 1 dhe 2 nga lektori i lëndës përkatëse në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit dhe titullarin e fakultetit dhe janë reflektuar ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e programit të kësaj disipline. Janë ngritur grupe pune për të rishikuar dhe përmirësuar syllabuset e lëndëve dhe janë reflektuar çdo semestër. Janë realizuar workshope për mënyrën e përgatitjes dhe përditësimit të syllabuseve.
- Për rekomandimin “*Të sigurohen tekste bazë në disa disiplina*”, Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka shtuar bashkëpunimin me institucione që operojnë në fushën e botimeve për median dhe komunikimin.



Për të shtuar tekstet bazë të nevojshme për programin “Bachelor” dhe “Master”, është identifikuar një listë me tituj botimesh nga kjo fushë të nxjerra nga Instituti Shqiptar i Medias dhe janë siguruar kopjet e nevojshme për bibliotekën.

- f. Për rekomandimin “*Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e Institucionit*”, është shtuar numri i titujve në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj nga autorë të rëndësishëm të fushës së komunikimit dhe medias. I është kushtuar rëndësi e veçantë titujve bashkëkohorë dhe botimeve më të reja. Institucioni ka bërë përpjekje të vazhdueshme në ofrimin e mundësive për burime elektronike nëpërmjet kontratave dhe bashkëpunimit me qendra të rëndësishme të ofrimit të literaturës bashkëkohore online. Nga ana tjetër, nisma të ndërmarra nga institucioni dhe studentët për pasurimin e bibliotekës kanë shtuar numrin e titujve në gjuhën shqipe dhe të huaj nga autorë të rëndësishëm të fushës së komunikimit dhe të medias, si dhe të marrëdhënieve publike. Një nismë e tillë ishte dhe fushata e studentëve të programit “Master”, viti i dytë “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”, e cila synonte pasurimin me libra të Bibliotekës së Universitetit dhe bibliotekave e shkollave të ndryshme. Në fund të fushatës, bibliotekës së KUB iu shtuan rreth 10 000 libra të rinj. Një nismë tjetër që ka kontribuar në pasurimin e bibliotekës së KUB, ka qenë edhe dhurimi i 3018 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë, gjatë muajit tetor 2018. Nga këta 3018 libra, 2018 ishin botime specike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit.
- g. Për rekomandimin “*Të realizohet një raport financiar për këtë program studimi*”, bazuar në përmasat e Institucionit, raporti financiar realizohet në rang institucioni, ku përfshihet edhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe përfshin dy programet e studimit, si atë në nivel “Bachelor”, ashtu dhe atë në nivel “Master i shkencave”.



PROGRAMI/ET E STUDIMEVE, MISIONI, ADMINISTRIMI

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin kombëtar e ndërkombëtar.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Kolegjin Universitar “Bedër” është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane. Në përputhje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Departamenti i Shkencave të Komunikimit vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave të komunikimit dhe medias.¹¹

Në këtë kuadër, departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit parashtron një arsim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar ta ndërtojnë karrierën e tyre profesionale si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, në fusha të ndryshme të përcjelljes së informacionit me anë të mjeteve të ndryshme, si edhe në fushën e marrëdhënieve me publikun.

Programi i studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi u ofron studentëve një formim profesional dhe intelektual bashkëkohor, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e komunikimit.

Misioni

Misioni i Departamentit të Shkencave të Komunikimit në programin “Bachelor” në Shkenca Komunikimi është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit, të marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si edhe mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe të projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, gjithnjë kjo në përputhje të vazhdueshme me zhvillimin e teknologjive bashkëkohore, që aktualisht, me futjen në treg të medieve on-line apo medieve të reja, janë zgjeruar edhe në fushën e medieve.


Realizimi i misionit

Misioni i Departamentit të Shkencave të Komunikimit për programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të Kolegjit Universitar “Bedër”, me standardet ndërkombëtare, si edhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky Institucion në vendin tonë dhe më gjerë.

Pas kalimit me sukses të procesit të akreditimit të parë, në vitin 2013, e në vazhdim, Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka kryer aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, inovacionit dhe kontributit për shoqërinë. Kjo edhe për të përmbushur misionin dhe rolin që institucionet e arsimit të lartë në tërësinë e tyre duhet të luajnë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin e tyre.

Departamenti ka zhvilluar aktivitetin e tij të mësimdhënies cilësore në ciklin e parë të studimeve në programin “Bachelor” në Shkenca Komunikimi. Ka organizuar dy konferenca shkencore ndërkombëtare në nivel departamenti dhe pesë konferenca ndërkombëtare në nivel fakulteti, ku kanë referuar studiues nga Shqipëria dhe shtete të tjera, tri Konferenca Studentore, ku kanë referuar studiues të rinj si nga niveli bachelor ashtu edhe ai master. Gjithashtu, ka organizuar takime dhe workshope të ndryshme në fushën e medias dhe komunikimit,

¹¹ Evidenca nr. 1: Vendimet e KM për licensimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe të programeve akademike të ofruara



projekte studimore, ndërgjegjësuere dhe informative në bashkëpunim me institucione, organizata brenda dhe jashtë vendit.

Vlen të përmenden dhe seria e paneleve të hapura, që kanë marrë pjesë personalitete të ndryshme, si ambasadorë, gazetarë, analistë ku janë trajtuar tema të larmishme në funksion të përditësimit të informacionit dhe të lobimit për përmirësimin dhe integrimin e medias shqiptare në një kuadër më të gjerë brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë periudhës universitare duke filluar nga viti akademik 2013-2014 e në vazhdim, Departamenti i Shkencave të Komunikimit u ka kushtuar rëndësi të veçantë aktiviteteve jashtë-kurrikulare të studentëve, nëpërmjet aktivizimit të tyre në aktivitete sociale, kulturore dhe sportive nëpërmjet klubeve studentore, organizimit të praktikave të punës në institucione publike dhe kompani private, brenda dhe jashtë vendit, vizitave në institucione të ndryshme (grupe mediatike, agjenci lajmesh, agjenci marketingu, biznese private), planifikimit të karrierës. Një praktikë shumë e suksesshme në këtë drejtim kanë qenë seritë e seminareve “MarCom” (Marketing & Komunikim) dhe “Studenti dhe profesioni”.


Seria e seminareve MarCom ka përfshirë trajtimin e temave të ndryshme të kategorisë Marketing & Komunikim, të cilat janë trajtuar nga të ftuar të ndryshëm të ardhur nga fusha e biznesit, institucioneve, agjencive të marketingut, etj. Lypset të përmendet këtu Fisnik Ismaili - profesor i Multimedias dhe Themelues e Drejtor Kreativ i agjencisë *Karrota*, Prishtinë, Kosovë; Rafaela Rica - themeluese dhe CEO pranë agjencisë *Iceberg Communication*; Elda Gjoka - themeluese dhe CEO pranë agjencisë *Genuine Effect*; Auron Pasha - drejtues i agjencisë së monitorimit *Idra Research & Consulting*; Gerti Boshnjaku - themelues dhe drejtor i revistës së marketingut digjital *Business Magazine Albania*; Elda Bajraktari - përfaqësuese e grupit mediatik *Çelësi*; Arlinda Çausholli - drejtore e PR pranë Aeroportit të Tiranës *Nënë Tereza*; Klodian Makashi - drejtues i agjencisë *Connex*; Olti Curri - moderator, autor emisionesh, blogger, influencer; Ilda Lumani - drejtore pranë revistës *Bordo*; Juela Isaj - drejtore menaxhuese pranë *DDB Albania & Montenegro*; Suela Shtylla - drejtuese e agjencisë *McCann Albania*; Odeta Malaj - drejtore menaxhuese e agjencisë *Landmark*, Edona Daçi - themeluese dhe menaxhere e portalit *Mundësi.al*; Galinija Gjoni - zv.-presidente e *Shoqatës së Ekspertëve të Pronësisë Intelektuale*; Eraldo Rexho - themelues dhe drejtor redaktorial te revista *Who* etj.

Në serinë e seminareve “Studenti dhe profesioni” janë zhvilluar takime të studentëve me personalitete në fushën e medias dhe gazetarë në karrierë, të cilët u kanë shpjeguar sfidat, kërkesat dhe “sekretet” e profesionit të gazetarit dhe përfaqësuesve të marrëdhënieve publike. Këtu mund të përmendim të ftuar të shumtë si: Ornela Liperi - kryeredaktore e revistës *Monitor*, Marin Mema - gazetar pranë grupit mediatik *Top News*, Denis Minga - gazetar pranë *News 24*, Pandi Gjata - kryeredaktor i lajmeve në *Top Chanel*, Enton Abilekaj - drejtor i Departamentit të Informacionit pranë *News 24*, Elert Yzeiri - drejtor i Web-it pranë *Top Channel*, Llazar Selimi - korrespondent i *Associated Press* në Shqipëri, Ardian Bunguri - drejtor i Reklamës dhe Marrëdhënieve me Publikun në BKT, Mimoza Çika Kelmendi - gazetare pranë *DW Deutsche Welle*, Desada Metaj - Gazetare në *TV Klan*, Eni Vasili - autore e programit *Studio e hapur*, Sokol Balla, Lutfi Dervishi, Fatos Hakorja, Arsen Hoxha etj.

Departamenti ka ndërmjetësuar disa marrëveshje bashkëpunimi midis Kolegjit Universitar “Bedër” me institucione të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Krahas ndërmjetësimit, Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në nivel njësie me institucione të fushës së medias dhe komunikimit, me qëllim realizimin e programit duke përfshirë në të aspektin praktik. Këto marrëveshje janë bërë bazë për organizimin e praktikave të studentëve dhe bashkëpunime të tjera në funksion të realizimit sa më mirë të aktivitetit të Departamentit.

Objektivat dhe kompetencat profesionale të programit të studimit

Duke paraqitur para studentëve programe të kompletuara për të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë profesionale në Shkencat e Komunikimit, *Gazetari* apo në *Komunikim* dhe *Marrëdhënie publike*, departamenti qëndron fort në misionin e tij për të përgatitur profesionistë të aftë në respektimin e deontologjisë dhe etikës profesionale, në analizën e thelluar e shkencore të fakteve dhe të situatave të ndryshme, në raportimin



e përcjelljen e një informacioni të saktë, e cila synojmë që të arrihet edhe nëpërmjet përfitimit nga ana e studentëve të një kulture të gjerë pluraliste, bashkëkohore mbi mënyrën e mendimit dhe konceptimit të situatave dhe ngjarjeve.

Si një departament i bazuar në kërkesa profesionale dhe me synimin për të përgatitur profesionistë të një shoqërie demokratike dhe të një zhvillimi mediatik e teknologjik bashkëkohor, ne kërkojmë të përmbushim misionin tonë, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të një komunikimi të qartë, që të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka transmetimi i informacionit në mediat e një shoqërie të lirë, si edhe rëndësinë e veçantë që ka komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun brenda institucioneve publike dhe private.


Njohja e teknologjive të reja të informacionit, e mjeteve të reja të komunikimit, kërkimi në fushën e Agjensive të Informacionit, përditësimi i programeve me njohuri për mediat e reja dhe hapësirat e mundësitë që krijojnë ato në komunikimin masiv, janë një nga objektivat kryesore për t'iu përshtatur një tregu gjithnjë në lëvizje e ecuri të vazhdueshme.

Përgjegjësia profesionale është formimi i studentëve, përgatitja e tyre si profesionistë, në mënyrë që ata të mund të kryejnë detyrën e rëndësishme të informimit të komunitetit dhe përmirësimin e përcjelljes së qartë të mesazhit në prezantimet publike e institucionale.


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹²
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5. Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Shkencave të Komunikimit janë hartuar në përputhje me objektivat dhe misionin e Kolegjit Universitar “Bedër” dhe janë në përputhje të plotë qoftë me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun unik europian dhe atë ndërkombëtar. <p>Kurrikulat bashkëkohore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar “Bedër” synojnë të përgatisin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Specialistë dhe profesionistë të shkencave të komunikimit, të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit dhe të marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme me to, të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale dhe të shpejtë të teknologjive moderne që kanë përfshirë fushën e komunikimit e të medias.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Kriteri 1: Si një departament i bazuar në preferenca profesionale, politikat zhvillimore të departamentit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Në këtë kuadër, sektori i komunikimit, medias dhe marrëdhënieve publike paraqitet si një ndër më prioritarët dhe me hapësirë të mjaftueshme për punësimin e të diplomuarve. Ky program ka qenë aktiv që në</p>

¹² GVB duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.



<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>themelimin e KUB, duke qenë pjesë e strategjisë së zhvillimit institucional. Vlen për tu përmendur çelja e një programi të ri bachelor brenda Departamentit të Shkencave të Komunikimit, si edhe dosja e dërguar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për riorganizim të programit BA në Shkenca Komunikimi, përmes të cilit synohet përditësimi i tij varësisht dinamikave që imponon tregu dhe strategjia e institucionit.</p> <p>Kriteri 2: Bazuar në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit Bachelor, programi i studimit të Ciklit të Parë pajis studentët me njohuritë bazë për metoda e parime shkencore të përgjithshme, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen shkencore-kërkimore, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe të projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe ndjekin zhvillimet bashkëkohore në fushën e komunikimit, medias e të mbarë shoqërisë.</p> <p>Kriteri 3: Duke synuar realizimin e misionit dhe objektivave të institucionit, ky program studimi përgatit profesionistë të aftë dhe të pajisur me shprehje dhe aftësi në disa profesione dhe specialitete të fushës së komunikimit që përfshijnë: gazetarë, specialistë të marrëdhënieve me publikun, zëdhënës shtypi, specialistë komunikimi, redaktorë, specialistë në fushën e marrëdhënieve me klientët, ideues, organizues dhe menaxhues fushatash të ndryshme komunikuese si në fushën e ndërgjegjësimit të publikut, ashtu edhe në kuadër të lobimit për organizma, organizata dhe institucione të ndryshme vendase dhe të huaja.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarëve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Kriteri 1: Politikat zhvillimore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Në këtë kuadër, sektori i medias, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun, veçanësisht me mundësitë e reja në epokën digjitale, paraqitet si një ndër sektorët më prioritarë dhe me hapësira të gjera për punësimin e të diplomuarve.</p> <p>Kriteri 2: Pas hapjes së programit në vitin 2011 dhe nevojave të përcaktuara varësisht kohës që u çel, për një rivlerësimin të nevojave të tregut të punës, Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka zhvilluar një studim të detajuar tregu. Studimi në fjalë përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve; numrin e të regjistruarëve në programe të ngjashme në institucionet simotra, numrin e kërkesave të maturantëve për këto programe, etj. Studimi u zhvillua nga një grup pune i ngritur brenda personelit të Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Varësisht sugjerimeve të bëra nga ky studim, Departamenti i Shkencave të Komunikimit dorëzoi pranë institucioneve shtetërore (Ministrisë respektive) dosjen për riorganizim programi studimi dhe çelje të programeve të reja.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe	



interesave kombëtare.

Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;

Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Kriteri 1: KUB në përgjithësi dhe konkretisht Departamenti i Shkencave të Komunikimit, i ka kushtuar vëmendje të veçantë që në çeljen e programeve të studimit që ato të jenë në përputhje me politikat dhe interesat kombëtare.

Programet e studimit në KUB janë në harmoni me zhvillimet më të fundit të Procesit të Bolonjës, reflektuar në komunikatën e Jerevanit. KUB synon që në programet e ofruara të rrisë cilësinë dhe përshtatshmërinë e programeve me zhvillimet e fundit të shkencës dhe teknologjisë. KUB në përgjithësi dhe në këtë rast Departamenti i Shkencave të Komunikimit nxit, nëpërmjet këtyre programeve, punësimin e të diplomuarëve.

Kriteri 2: Gjatë gjithë këtyre viteve, KUB i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ruajtjes, zhvillimit dhe promovimit të vlerave kulturore kombëtare. Në nivel institucional, KUB është përpjekur që ta promovojë kulturën shqiptare edhe tek studentët që kanë ardhur nga shumë vende të ndryshme. Në rastin konkret, Departamenti i Shkencave të Komunikimit në programet që ofron në nivelin e parë dhe të dytë të studimeve, ka synuar që të ndihmojë në ruajtjen e këtyre vlerave kombëtare duke u mundësuar bursa studimi disa studentëve shqiptarë që kanë ardhur nga trojet shqiptare jashtë kufijve zyrtarë, konkretisht nga Kosova, Lugina e Preshevës etj.

Një formë tjetër e ruajtjes së vlerave kulturore kombëtare është edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme të ndërmara nga departamenti. Gjatë vitit akademik 2016-2017, një projekt studentor “Një muze për At Gjergj Fishtën”, nëpërmjet një larmie aktiviteteve të organizuara, synoi për të ndërgjegjësuar opinionin publik si dhe aktorët e përfshirë në domosdoshmërinë e vlerësimit të figurës së At Gjergj Fishtës, përjetësimin e veprës së tij dhe ndërtimin e një shtëpie-muze në vendin e tij të lindjes. Gjatë vitit akademik 2017-2018, një projekt studentor i titulluar “Një libër më shumë për Preshevën” synoi në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe grumbullimin e librave në gjuhën shqipe dhe mjeteve shkollore për fëmijët e luginës së Preshevës, të cilat në Maj 2018 u dorëzuan në komunën e Bujanocit nga një grup përfaqësues me studentë dhe pedagogë nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe drejtues të institucionit.

Aktualisht, gjatë vitit akademik 2018-2019, një projekt studentor i titulluar “Ruaj traditën, festo shqip” ka si objektiv realizimin e një sërë aktiviteteve për të arritur ndërgjegjësimin e të rinjve për të ruajtur e kultivuar folklorin shqiptar.

Konkluzione të GVB:

Mbështetur në një shqyrtimin të detajuar të dokumentacionit respektiv, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të programit të studimit diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara dhe konstaton se standardet janë **përmbushur plotësisht**. Institucioni dëshmon se funksionon në përputhje me parashikimin e statutit dhe rregulloreve të tij të brendshme.

Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit; me standartet e përcaktuara, në përshtatje me kërkesat dhe mundësitë e tregut të punës të studiuar dhe përditësuara, si edhe me zhvillimin ekonomik të vendit, duke patur objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve me dije dhe aftësi të përshtatshme për nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për profesionin përkatës. Këto programe studimi janë në shërbim të interesave kombëtare si dhe ruajtjes dhe përcimit të vlerave kulturore kombëtare.



2. *Struktura akademike e Fakultetit dhe Departamentit të Komunikimit*

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Organigrama (strukturat akademike të Fakultetit, ndarja në Departamente), të dhëna për ndarjen e personelit në këto njësi bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

KUB dhe Fakulteti i Shkencave Humane

KUB organizohet në 2 fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit. KUB ka në përbërje të tij 6 njësi bazë departamente, dy qendra kërkimore zhvillimore, si edhe njësitë ndihmëse administrative, sipas organigramës së miratuar. Njësitë e lartpërmendura operojnë në bazë të parimit të autonomisë brenda kompetencave të tyre.

Fakulteti i Shkencave Humane në Kolegjin Universitar “Bedër” është i angazhuar për nxitjen e mendimit kritik intelektual dhe synon një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.

Misioni i Fakultetit të Shkencave Humane është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e shkencave islame, të komunikimit, të drejtësisë, dhe të disiplinave të ndërlidhura me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen të kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut, zhvillimin e teknologjisë së komunikimit e medias si dhe zhvillimin e mbarë shoqërisë.

Përçimi tek studentët i njohurive të nivelit bashkëkohor universitar, të përditësuara këto në fushat e sipërpërmendura, i pajisin ata me njohuri të cilat u japin mundësinë për të vazhduar studimet e thelluara në disiplinat e shkencave humane, brenda dhe jashtë vendit.

DEKANATI


Dekanatet e Kolegjit Universitar “Bedër” janë organe kolegjiale ekzekutive të njësive kryesore përkatëse. Dekanati përbëhet nga:

- a. dekani;
- b. zëvendëskanani;
- c. përgjegjësit e njësisë bazë;
- d. administratori i njësisë kryesore;

Funksionet dhe detyrat e tjera të dekanatit

Funksionet e dekanatit janë si më poshtë:

- a) harton planin disavjeçar të zhvillimit të njësisë kryesore;
- b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Rektorat dhe Senat;
- c) propozon kriteret për shpërndarjen e burimeve materiale dhe njerëzore akademike të njësisë kryesore;
- d) harton dhe propozon projektbuxhetin për njësinë kryesore;
- e) paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- f) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik.
- g) Funksionet e tjera të Dekanatit përcaktohen në rregulloren e tij si dhe në rregulloret e tjera të institucionit.



Mbledhjet dhe vendimmarrja e dekanatit

1. Dekanati mblidhet si rregull jo më pak se një herë në muaj. Në raste të nevojshme dekanati mund të mblidhet në çdo kohë, me kusht që të lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e materialeve që lidhen me çështjet për diskutim.
2. Mbledhja thirret nga dekani, kryesisht, apo me kërkesën e secilit prej anëtarëve të dekanatit.
3. Mbledhja konsiderohet e vlefshme, nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
4. Mbledhja nuk mund të zhvillohet dhe duhet të shtyhet, në rastet kur, edhe pse është plotësuar numri i anëtarëve të nevojshëm, nuk është prezent anëtari, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen për të cilën do të merret vendim.
Kontratat e punës që nënshkruhen në Kolegjin Universitar “Bedër”, lidhur me personelin akademik, janë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kontrata e punës mund të jetë me afat dhe/ose pa-afat në bazë të kategorisë së personelit akademik dhe kohës së punësimit të tij pranë KUB. Në të përshkruhen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet që kanë palët nënshkruese të kontratës. Bashkangjitur kontratës ndodhet dhe një ankes kontratë në të cilën përcaktohet vendi i punës, pozicioni, të drejtat dhe detyrat e punëmarrësit. Këto të drejta dhe detyrime i bëhen të ditura personelit në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe aneksit të saj.¹⁷ Kontrata e punës bazohet në ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me arsimin e lartë jo publik në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, në Statutin, Rregulloren Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër” si dhe Rregulloret e tjera të Kolegjit Universitar “Bedër”. Një kopje e kontratës e firmosur nga personeli dhe drejtuesi përkatës ndodhet në dosjen e personelit pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Kriteri 1: Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren. Kjo procedurë parashikohet si në statutin e KUB ¹⁸ , po ashtu edhe në rregulloren themelore ¹⁹ të institucionit dhe në procedurën e punësimit të personelit ²⁰ . Siç parashikohet edhe nenin 61 të Statutit, kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, pas pëlqimit të Dekanit dhe miratimit nga Rektori. Përzgjedhja e kandidatit drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga njësia bazë përkatëse. Komisioni ad-hoc bën renditjen e kandidaturave, ia propozon Rektorit dhe ky i fundit bën emërimin me kohë të plotë të punonjësit. Në mënyrë më të detajuar, kriteret dhe procedurat parashikohen në procedurën e punësimit të personelit.
Kriteri 2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	Kriteri 2: Bazuar në tabelat e mësipërme, personeli akademik me kohë të plotë përbën mbi 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e studimeve të ciklit të parë, Bachelor në Shkenca Komunikimi.

¹⁷ Evidenca nr. 15: Modeli i kontratës së personelit akademik

¹⁸ Evidenca nr. 4: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 61

¹⁹ Evidenca nr. 5: Rregullorja Themelore, Neni 26

²⁰ Evidenca nr. 13: Procedura e punësimit të personelit



<p>Kriteri 3 .Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4. Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Kriteri 3: Vlerësimi i efektshmërisë së pedagogëve bëhet përmes disa mënyrave, e cila rregullohet sipas rregullores së anketave dhe vlerësimit.²¹</p> <p>Pedagogët vlerësohen përmes anketimeve të studentëve²², vetëvlerësimit të tyre, si edhe vlerësimit të eprorit brenda njësisë²³.</p> <p>Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të zhvilluara, studentët japin mendimin e tyre për pedagogun dhe brendinë e lëndës. Kjo anketë realizohet para provimit përfundimtar të çdo semestri akademik dhe përmban disa kritere vlerësimi për të siguruar plotësimin e të gjitha aspekteve të mbarëvajtjes dhe nxënies gjatë programit akademik.</p> <p>Kriteri 4: KUB ndjek një politikë efikase për punësimin e personelit akademik të kualifikuar, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Politikat dhe strategjia e punësimit përcaktohen në statut, në rregulloren themelore dhe në rregulloren dhe procedurën e punësimit, e cila parashikon hapat e punësimit të personelit akademik të sipërpërmendur, gjë kjo që realizohet përmes një zinxhiri komunikimi formal nga departamenti, në fakultet dhe më pas në rektorat.</p> <p>Sipas kësaj proçedure, vendet e lira shpallen ne Web-in e institucionit dhe/ose pranë zyrës së punës, sipas lajmërimit të përgatitur nga zyra e burimeve njerëzore, në përputhje me procedurat e ndjekura për punësimin në vendet e lira.</p> <p>Për një funksionim sa më të suksesshëm, KUB aplikon edhe punësimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor, si edhe të atij administrativ.²⁴</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3. Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të</p>	<p>Kriteri 1: Zyra e Burimeve Njerëzore disponon një dosje të posaçme për çdo anëtar të personelit akademik dhe administrativ, të përditësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi.²⁵</p> <p>Kriteri 2: Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Çdo fillim semestri, me propozim të njësisë bazë, aprovim të dekanatit dhe miratim të rektoratit përcaktohet ngarkesa mësimore për secilin anëtar të personelit akademik të çdo departamenti. Shembull i kësaj procedure mund të vërehet në Evidencën 20.²⁶</p> <p>Kriteri 3: Siç u përmend edhe më lartë, KUB publikon vendet e lira të punës dhe kriteret e nevojshme në faqen e tij në WEB, ose/dhe</p>

²¹ Evidenca nr. 16: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve


²² Evidenca nr. 17: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

²³ Evidenca nr. 18: Formular mbi vlerësimin e performancës së personelit

²⁴ Evidenca nr. 14: Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik

²⁵ Evidenca nr. 21: CV-të e personelit akademik


²⁶ Evidenca nr. 20: Udhëzim "Për ngarkesën mësimore"



<p>personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4. Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Zyrën e Punës.</p> <p>Kriteri 4: KUB ka angazhuar si titullarë të lëndëve për programin e studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor”. Në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në fuqi, titullarët e lëndëve që nuk kanë gradën shkencore “Doktor”, kanë përfunduar programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”/ “Master i arteve të bukura” ose programe të barasvlefshme me to dhe/ose njëkohësisht, vijojnë studimet e Doktoratës.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor</p>	<p>Kriter 1: Departamenti i Shkencave të Komunikimit ofron programe studimi ku gërshetohen njohuritë teorike me ato praktike. Varësisht nevojave të programit, Departamenti angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor, qoftë kjo varësisht nevojës së mësimdhënies-mësimnxënies, po ashtu edhe kur ndihet nevoja e aspekteve praktike. Edhe pse mësimdhënia përgjithësisht mbështetet në leksione dhe seminare të integruara me njëra-tjetrën dhe nuk ka orë të mirë-caktuara laboratorike, në ndihmë të studentëve është vënë redaksia e informacionit për portalin informativ www.objektiv.al, i cili përdoret për arsye praktike profesionale. Ndër vite, studentët e këtij departamenti, të mbështetur edhe nga anëtarët e personelit akademik kanë botuar revistën <i>Objektiv</i> – version i printuar dhe online.²⁷</p> <p>Kriteri 2: Angazhimi i personelit aktual akademik ka synuar dhe arritur një punë optimale për përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë. Kjo realizohet si në aspektin e mësimdhënies e mësimnxënies brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit. Kjo mundëson zbatimin në praktikë të aspekteve teorike të programit, të cilat sigurojnë përvetësim dhe aftësim më të plotë si nga ana e aspekteve teorike dhe praktike.</p> <p>Angazhimi i këshilltarëve akademikë është një formë efektive për të orientuar studentët në përzgjedhjen e lëndëve në përputhje me programin e studimeve (si lëndët e detyrueshme, ashtu edhe ato me zgjedhje). Këshilltarët akademikë janë orientuesit e studentëve në faza të ndryshme gjatë zhvillimit të këtij programi studimesh në lidhje me kërkesat, rregulloret, kushtet e diplomimit si dhe për t’i këshilluar në lidhje me karrierën e tyre pas diplomimit.²⁸</p> <p>Kriteri 3: Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi mbështet në dy akse kryesore, teorike dhe praktike. Ndërkohë që përgatitja teorike i besohet orëve në auditor, aspekti praktik është organizuar në dy forma kryesore. E para, lidhet me aktivitetin e Zyrës së Planifikimit të Karrierës, ku çdo fillim viti departamenti përcakton një përfaqësues të</p>

²⁷ Evidenca nr. 24: Vendim senati për hapjen e revistës Objektiv

²⁸ Evidenca nr. 12: Emërimi i këshilltarëve akademikë



për 12 studentë).	tijn në këtë zyrë. Funksionet e kësaj zyre parashikohen në nenin 42 të Rregullores së Organizimit Administrativ. ²⁹ Nga ana tjetër, ka një lëndë të posaçme të Praktikës profesionale, ku studentët ndahen në grupe nën drejtimin e disa pedagogëve dhe varësisht interesit të tyre zhvillojnë praktikë. Raporti pedagog studentë në këtë lëndë është rreth 1 me 7.
Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Kriter 1: KUB nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatisin dhe zbatojnë një plan veprimi konkret në lidhje me trajnimet e domosdoshme për integrimin e personelit. Një shembull i kësaj praktike mund të gjendet në evidencën nr. 23³⁰. Gjithashtu, disa prej këtyre trajnimeve pasqyrohen edhe në faqen e NJSBC, www.qac.beder.edu.al.³¹</p> <p>E rëndësishme në këtë proces është se një pjesë e konsiderueshme e temave përcaktohet nga nevojat e propozuara nga vetë personeli akademik dhe administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore përmes një emaili zyrtar njofton të gjithë anëtarët e personelit për të propozuar tema të cilat ata i gjykojnë si të arsyeshme dhe të nevojshme, të cilat ndihmojnë për hartimin e planit të trajnimeve.</p> <p>Kriteri 2: Institucioni ka në dispozicion një bazë të dhënash për të gjitha programet e ofruara duke i mbajtur ato në dy forma, si atë të printuar ashtu edhe në formë dixhitale, të cilat përditësohen vazhdimisht.</p>
<p>Konkluzione të GVB:</p> <p>Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të Departamentit diskutoi në mënyrë hollësisht përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara dhe e miratoi atë me konsensus. GVB konstaton se programi në fjalë i përmbysh plotësisht kriteret e kërkuara.</p> <p>Grupi i vlerësimit të brendshëm vlerëson se për fushën e vlerësimit “Personeli i institucionit” standardet janë përmbyshur plotësisht. Institucioni, nëpërmjet rregulloreve përkatëse, ka përcaktuar qartë funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe atyre mbështetëse, si dhe përshkrimet e punës për çdo pozicion. Kjo gjë siguron menaxhimin efikas të aktivitetit të tij. Institucioni ndjek politika efektive për punësimin, vlerësimin dhe promovimin e personelit, praktikë kjo që ka ndihmuar në sigurimin e punësimit të një personeli të kualifikuar akademik e administrativ. Institucioni ndjek dhe zhvillon në mënyrë të vazhdueshme politikën për mbështetjen e personelit me programe të trajnimit dhe të formimit të vazhduar. Institucioni siguron ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet njësive përkatëse dhe ka në dispozicion dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.</p>	

²⁹ Evidenca nr. 7: Rregullore “Për organizimin administrativ”

³⁰ Evidenca nr. 23: Plan veprimi i trajnimeve të personelit

³¹ Evidenca nr. 28: Lista e trainimeve të organizuara për personelin 2014-2018

INFRASTRUKTURA NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT, LOGJISTIKA DHE SHËRBIME TË TJERA NDAJ KOMUNITETIT

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

KUB vazhdon aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira për një periudhë dhjetëvjeçare, me sipërfaqe në total 5628 m². Infrastruktura e përdorur plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 4 të shtojcës nr.3 të udhëzimit të MASH, nr.11, datë 28.02.2011 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit” që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimit.

Godina A, 8 kate - me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 3957 m², ku zhvillojnë kryesisht mësimin sipas orareve të përcaktuara departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit.

Godina B, 2 kate – me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 1671 m², ku zhvillojnë kryesisht mësimin sipas orareve të përcaktuara departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit.

Godinat kanë një infrastrukturë moderne dhe janë të pajisura me kondicionerë. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor.

Në godinën A, përveç klasave të mësimin, ndodhet edhe muzeu i medias, salla e gjyqit, laborator i informatikës, biblioteka që ka shërbim klasik dhe dixhital dhe ambiente çlodhëse për studentët, si mensë, mjedise për këshillin studentor, për klubet studentore, si dhe mjedise të shërbimit shëndetësor (mjekësor).

Në godinën B, krahas klasave dhe zyrave, ndodhen ambiente për veprimtari të planifikimit të karrierës dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare. Gjithashtu është prezent ambienti i palestrës, që studentët dhe personeli mund ta shfrytëzojnë për aktivitete individuale sportive.

Godinat e mësipërme janë të pajisura me certifikatat përkatëse të pronësisë dhe disponojnë vërtetimet përkatëse për mbrojtjen kundër zjarrit dhe lejen higjieno-sanitare, sipas përcaktimeve ligjore.

Sipas numrit të studentëve që aktualisht ndjekin studimet në IAL, institucioni ofron mesatarisht 8.1 m²/student dhe 1 boks/15 studentë.

KUB disponon në total 47 bokse hidro-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. Duke iu referuar numrit të studentëve, institucioni ynë plotëson normativën për nyjet hidro-sanitare të parashikuara në udhëzimet respektive.

KUB ka vënë në dispozicion për mësimdhënie objekte të ndërtaura (ose rindërtaura) me materiale cilësore bashkëkohore dhe që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë.

KUB plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon me ndriçim, minimalisht 15 – 20% të sipërfaqes së dyshemesë i cili është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, mundësisht nga juglindja. Kjo gjë vërtetohet nga planimetria e ndërtesës së bashkëngjitur. Ka dalje dhe shkallë emergjence. Kjo gjë vërtetohet nga raporti i zjarrfikësve, i bashkëngjitur. KUB ka sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike. Kjo gjë vërtetohet nga raporti i zjarrfikësve. KUB ka funksional sistemin e ngrohjes. KUB ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogjenerator etj.), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (depozita uji). Kjo gjë vërtetohet dhe në relacionin teknik që gjendet pranë Zyrës së Financës dhe Çështjeve Administrative ³²

³² Evidenca nr. 27: Planimetria e ambienteve në KUB



Tregues të matshëm:
 Mjediset e fakulteteve dhe KUB
Tabela 7: Mjediset për fakultetet dhe KUB

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	4	358
Klasa për seminare	13	686
Salla për aktivitete promovuese	1	268.6
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	1	25
Sallë konference	1	350
Laboratorë informatike	1	44.6
Salla interneti	1	40
Salla për bibliotekë	1	230
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	16
Zyrë informacioni për studentët	3	75
Korridore/holle/shkallë	25	1807.7
Mjedise sportive	1	150
Mjedise shërbimi për të tretë	1	40
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1	32
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	80
Nyje hidrosanitare për studentët	38	171
Etj....		370
Norma m²/për student		8.1

Tabela 8: Mjediset për personelin

Mjediset për personelin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Rektorin, Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	4	180
Zyra për sekretarinë mësimore	1	35
Zyra për departamentet	6	105
Zyra për personelin akademik	16	340
Zyrë për financën	1	14
Zyrë për Njësinë e SBC	1	21
Salla për mbledhje	2	94
Mjedis për personelin e shërbimit	2	30
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	13	65
Norma m²/për person		9.4

 Dokumentacioni përkatës (planimetritë) në Evidenca Nr. 27
Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në	Institucioni nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë ndjek politika mbështetëse për studentët. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Kjo parashikohet

<p>sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2. Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3. Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5. Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>në nenin 6 të rregullores për studimet e ciklit të parë dhe provimeve.³³</p> <p>Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekë të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi.</p> <p>Biblioteka e KUB, e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga e hëna në të shtunë, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total rreth 36 000. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KUB.³⁴</p> <p>KUB parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës.</p> <p>Pasurimi i bibliotekës është bërë gjithashtu edhe përmes një projekti studentor “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”, i organizuar përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, nga studentët e departamentit të Shkencave të Komunikimit, në kuadër të së cilës u mbledhën rreth 10 000 libra. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjetër u dhurua për shkolla, institucione të tjera dhe grupe në nevojë. Një nismë tjetër që ka kontribuar në pasurimin e bibliotekës së KUB, ka qenë edhe dhurimi i 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë, gjatë muajit tetor 2018. Nga këta 318 libra, 218 ishin botime specifike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit.</p> <p>KUB ofron nëpërmjet bibliotekës literaturë shumëdisiplinare. Oraret e punës të bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Ato janë të bëra publike në hyrje të bibliotekës, mjediset e së cilës janë të disponueshme nga ora 8:30 deri në orën 19:00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës.</p> <p>Në funksion të bibliotekës, KUB ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike.</p> <p>Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online Ebsco Host ku studentët kanë akses në 45000 libra dhe 5000 revista. Gjithashtu biblioteka e KUB mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.


³³ Evidenca nr. 22: Rregullore “Për studimet e ciklit të parë dhe provimeve”

³⁴ Evidenca nr. 31: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Kriteri 1 : Varësisht nevojave të programeve akademike, KUB ofron mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë Qendra e medias dhe komunikimit, laborator i gjuhëve të huaja, laborator i kompjuterave, salla e gjyqit etj.</p> <p>Siç paraqitet edhe në përshkrimin e mësipërm tabelar për infrastrukturën, KUB dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme hapësira, si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.</p> <p>Kriteri 2: Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si tabelë interaktive, projektorë, kompjuter, internet. Të gjitha mjediset mësimore, janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm.</p> <p>Kriteri 3: Programet e ofruara nga KUB nuk janë të natyrës teknike, për të cilat nevojiten laboratorë eksperimentimi. Për të përmbushur nevojat e programeve janë ngritur Laboratori i Gjuhëve të Huaja, Qendra e Medias dhe e Komunikimit, laborator i informatikës etj..</p> <p>Kriteri 4: Siç u përmend edhe në kriterin e mësipërm, programet e ofruara nga KUB nuk janë të natyrës teknike, për të cilat nevojiten laboratorë eksperimentimi. Për të përmbushur nevojat e programeve janë ngritur laborator i Gjuhëve të Huaja, Qendra e Medias dhe e Komunikimit etj. Në rastin e programit BA në Shkenca Komunikimi, vlen për t'u vlerësuar redaksia e informacionit të portalit informativ www.objektiv.al.</p> <p>Kriteri 5: KUB, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë dhe gjuhësi. Ndërkohë, KUB është i pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor. Pajisja e ambienteve mësimore me kushte kondicionimi, tabela interaktive (Smart Board), projektorë, kompjutera, karrige ortopedike etj., mundësojnë një proces mësimor cilësor.³⁵</p> <p>Kriteri 6 : KUB, veçanërisht departamenti i Shkencave të Komunikimit u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Prandaj, gjatë vitit studentët nxiten dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale. KUB ndër vite ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme mediatike, ku studentët gjatë periudhës së verës zhvillojnë këto praktika.³⁶</p> <p>Ndërkohë, KUB ka ofruar mundësi praktikash profesionale edhe brenda Institucionit, siç është Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, revista Objektiv dhe portali objektiv.al</p>
--	--

³⁵ Evidenca nr. 32: Lista e infrastrukturës teknologjike

³⁶ Evidenca nr. 33: Listë e praktikave studentore



Konkluzione të GVB:


Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të departamentit diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara dhe konstatoi se Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët nëpërmjet bibliotekës, që ofron një gamë të gjerë titujsh të përzgjedhur, në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KUB si fizikisht, ashtu edhe *online*. Institucioni tregon angazhim që të pasurojë herë pas here bibliotekën me tituj të rinj nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet përkatëse dhe projekteve të iniciuara nga studentët apo personeli akademik.

Institucioni garanton zhvillimin e procesit mësimor nëpërmjet shërbimit të sigurisë, në ambientet e institucionit, shërbimit higjieno-sanitar dhe përkujdesjes shëndetësore, si dhe angazhimit të personelit në organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale dhe kulturore.

Institucioni ka siguruar mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për organizimin e veprimtarisë akademiko-shkencore dhe mbetet i angazhuar për ndjekjen dhe përmirësimin e tyre nëpërmjet sallave të leksioneve, seminareve, laboratorëve të kompjuterave të pajisur me teknologji bashkëkohore. Nga ana tjetër, institucioni në perspektivë do të zhvendoset në mjediset e reja të kampusit universitar, gjë që do t'i sjellë një menaxhim dhe kushte akoma më cilësore në këtë drejtim.

Institucioni nëpërmjet praktikave profesionale dhe marrëveshjeve të nënshkruara me institucione dhe kompani të ndryshme mundëson akomodimin e studentëve për praktikat profesionale si dhe një tranzicion të lehtë në punësim.

GVB konstaton se programi "Bachelor" në Shkenca Komunikimi i **përbush plotësisht** kriteret e kërkuara për infrastrukturën dhe logjistikën dhe e miratoi atë me konsensus.



FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar "Bedër" është institucion i arsimit të lartë privat jofitimprurës. Pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit vijnë nga pagesat e studentëve dhe donacionet. Institucioni ka të drejtë të pranojë mbështetje financiare dhe materiale që lidhet me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Në tabelat e mëposhtme gjenden të ardhurat gjatë viteve, shpenzimet totale si edhe shpenzimet për student.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit

Tabela 9: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit

Të ardhurat nga:	2013-2014	2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018	2018-2019*
Pushteti qendror						
Pushteti vendor						
Fonde jopublike:						
Grantet për kërkim dhe kontratat	206,000			1,312,193		
Konsulencat, shërbimet	1,216,000		2,176,640	166,652	9,027,774	376,050
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	69,279,180	72,676,750	85,746,511	81.141.671	64,625,526	28,011,220
Sponsorizimet						
Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm)						
Donacione, aktivitete siguroese, fondacione etj	48,463,997	97,021,093	72,079,844	33.359.263	28,350,000	1,224,600
Aktivitete tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)						
SHUMA (lekë)	119,165,177	169,697,843	160,002,995	115,979,779	102,003,300	29,611,870

* Viti 2018-2019 do të përditësohet sërish në muajin dhjetor 2018

- Shpenzimet në 6 vitet e fundit

Tabela 10: Shpenzimet në 6 vitet e fundit

Shpenzimet	2013-2014	2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018	2018-2019*
Paga dhe sigurime	66,879,070	106,001,062	104,369,614	76,862,838	66,974,294	19,679,662
Shpenzime operative	52,286,107	63,696,781	55,633,381	39,116,941	34,172,206	9,092,950
Investime					856,800	
SHUMA (LEKË)	119,165,177	169,697,843	160,002,995	115,979,779	102,003,300	28,772,612

* Viti 2018-2019 do të përditësohet sërish në muajin dhjetor 2018

- Shpenzimet për studentët që ndjekin programin e studimit, kosto e studimit për student për vit akademik

Shpenzimet për student për vitin akademik 2013-2014 ishin 177,066 ALL 2014-2015 ishin 210,543 LEKË, 2015-2016 ishin 215,637 LEKË, 2016-2017 ishin 165,449 LEKË dhe 2017-2018 ishin 153,619 LEKË.

- Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet

Të hyrat dhe të dalat financiare të institucionit kontrollohen në mënyrë të rregullt nga institucionet kompetente shtetërore. Institucioni mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Përveç kësaj, institucioni merr ndihmë për të gjitha çështjet financiare, tatimore, çështjet e kontabilitetit nga ekspertë kontabiliteti, të jashtëm.


- Kapacitetet menaxhuese financiare

Menaxhimi financiar i institucionit është nën kontrollin e Fondacionit Hafiz Ali Korca dhe administrohen në bashkëpunim me administratorin e Kolegjit Universitar Bedër.

Dokumentacioni përkatës është i disponueshëm pranë Zyrës së Financës së institucionit në çdo kohë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbyshja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Raportet financiare hartohen sipas legjislacionit në fuqi nga fondacioni, pjesë e të cilit është Kolegji Universitar Bedër, brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Këto raporte arkivohen çdo vit pranë drejtorisë përkatëse dhe auditohen sipas legjislacionit në fuqi duke realizuar si auditime të brendshme, ashtu edhe të jashtme.</p> <p>Gjithashtu, KUB i paraqet çdo fundviti akademik Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik si edhe projektbuxheti afatmesëm.</p> <p>Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KUB bëhet në bazë të një programi financiar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në Ligjin Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë, në Ligjin Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.</p> <p>Kolegji Universitar "Bedër", gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Në raportet financiare si dhe në raportet e auditimit janë pasqyruar në mënyrë të qartë të gjitha të ardhurat e realizuara, si të ardhurat nga tarifat e shkollimit të studentëve, nga projekte të ndryshme me partnerë vendas dhe të huaj, ashtu edhe të ardhurat nga donacione të ndryshme bazuar në pjesëmarrjen në projekte, apo dhe donacione nga institucione apo donatorë vendas e të huaj të mbështetura nga kontratat përkatëse të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të studimeve të ciklit të parë, ashtu dhe shpenzimet e kryera për realizimin e aktivitetit të institucionit, së bashku me bursat e ndryshme (sociale, ekselence, talenti) të ofruara për studentët në</p>



	të gjitha fazat e programeve të studimit të ciklit të parë.
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Çdo vit, fondacioni harton një raport nga një Kontabilist i Miratuar të situatës financiare dhe ky raport ruhet pranë Fondacionit.</p> <p>Në raporte paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka Institucioni, të detajuara sipas llojit, burimit dhe destinacionit të tyre. Brenda raportit janë të specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkte apo indirekte.</p> <p>Në raport paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative etj. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p>Raportet financiare hartohen sipas legjislacionit në fuqi nga fondacioni, pjesë e të cilit është Kolegji Universitar “Bedër”, brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>Siç u përmend edhe mësipër, KUB i paraqet çdo fundviti akademik Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik si edhe projektbuxheti afatmesëm.</p> <p>Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KUB bëhet në bazë të një programi financiar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në Ligjin Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë, në Ligjin Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.</p> <p>Kolegji Universitar “Bedër”, gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Duke vlerësuar veprimtarinë e derimëtanishme, KUB dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe bashkë me mbështetjen e donatorëve ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>
Konkluzione të GVB:	
<p>Pas përfundimit të raportit të hartuar, ku vërehet një qëndrueshmëri financiare institucionale, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të programit Bachelor në Shkenca Komunikimi diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara dhe e miratoi atë me konsensus. Menaxhimi financiar i institucionit është nën kontrollin e Fondacionit “Hafiz Ali Korça” dhe administrohet në bashkëpunim me administratorin. Institucioni harton, dokumenton dhe ruan raportet përkatëse financiare në përputhje me legjislacionin dhe fondacionin, pjesë e të cilit është ky institucion. Këto raporte dokumentohen dhe auditohen nga auditorë të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Raportet tregojnë stabilitet financiar dhe kapacitete për zhvillim në të ardhmen. GVB konstaton se programi “Bachelor” në Shkenca Komunikimi i përmbush plotësisht kriteret e kërkuara.</p>	

SISTEMI I BRENDSHËM I SIGURIMIT TË CILËSISË, NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Pjesa përshkrimore


Terma reference: ngritja dhe institucionalizimi i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

KUB është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e studentëve, sipas standarteve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për verifikimin periodik të cilësisë dhe përmirësimin e saj janë krijuar Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjBSC), e cila përbëhet nga pesë anëtarë, tre pedagogë të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm. Kjo njësi varet drejtpërdrejt nga Rektori; ajo ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia kryen vëzhgime dhe studime të vazhdueshme në procesin mësimor dhe shkencor, duke përgatitur raporte me shkrim.

Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë:

- Të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik.
- Të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit për të hartuar standardet për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë.
- Të vlerësojë, në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet.
- Të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji, në bashkëpunim me njësitë përkatëse.
- Të hulumtojë në lidhje me modelet e ndryshme, në kuadër të përmirësimit të cilësisë, që mund të merren si shembull, si edhe shpërndarjen e tyre në njësitë e tjera akademike dhe administrative.
- Njofton njësitë për vendimet e marra, mbikëqyr zbatimin e procesit të punës në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron rezultatet e kësaj pune.
- Ndjek procesin e vlerësimit të brendshëm të institucionit, si dhe mbikëqyrjen e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit.
- Ndjek përgatitjen e terrenit për ‘vlerësimin e jashtëm’ të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe vënien në dispozicion të institucionit ose organizatës së vlerësimit të jashtëm të çdo informacioni të nevojshëm.
- Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në bashkëpunim me sekretarinë mësimore.
- Pas çdo vlerësimi raporton para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.

Njëkohësisht, duhet theksuar se në janar 2010, KUB është pajisur me certifikatën ISO 9001:2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Për të mbikëqyrur zbatimin korrekt të të gjitha proceseve dhe procedurave të punës të parashikuara sipas standardit ISO, në KUB cdo vit është ngritur Grupi i Auditit të Brendshëm Ad-hoc, i cili nëpërmjet kryerjes së auditimeve periodike siguron zbatimin e proceseve dhe procedurave në fjalë në institucion.



Tregues të matshëm:
 Të dhëna për anëtarët e NJBSC
Tabela 11: Anëtarët e NJBSC

	Anëtarët e NJBSC	Detyra që ka në NJBSC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Dr. Nertil Berdufi	Kryetar	1 vit
2	Doc.dr. Ramadan Çipuri	Ekspert i jashtëm	1 vit
3	MSc. Ermira Bushi	Anëtare	1 vit
4	Kristi Mukollari	Anëtar, përfaqësues i studentit	Nga 12.12.2018
5	MSc Eduina Maksuti	Anëtare, Relatore	1 vit

 Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC:

KUB ka një rregullore të posaçme për vlerësimin e personelit në çdo fund semestri dhe viti akademik. Procedura dhe mënyra e vlerësimit organizohet sipas rregullores mbi anketat dhe vlerësimet, e cila përfshin vlerësimet e studentëve për personelin, vetëvlerësimin e personelit, vlerësimin e eprorëve për vartësit etj. Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies. Anketimet me studentë zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri. Për një periudhë gjashtë vjeçare janë zhvilluar 12 anketime të tilla me studentë.

Duke synuar garantimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe kualifikimet e personelit në fushën e kërkimit shkencor, KUB gjatë kësaj periudhe ka organizuar disa trajnime, të cilat janë mbështetur nga Këshilli i Sigurimit të Cilësisë dhe zyra e burimeve njerëzore.

KUB i ka kushtuar një rëndësi të veçantë proceseve të ndryshme vetëvlerësuese, qofshin këto në lidhje me aspektin administrativ të institucionit, po aq edhe me aspektin akademik. Çdo fund viti, njësitë bazë dhe kryesore përgatisin raportin vjetor të cilin e dërgojnë në rektorat. Në këto raporte, përveç pasqyrimin të aktiviteteve, rëndësi i kushtohet edhe analizës SWOT.³⁷

Një metodë e rëndësishme për të përmirësuar punët në njësitë kryesore, bazë dhe administrative është edhe organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të vetëvlerësimit të përgatitura nga ato. Në këto analiza vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten.

Nisur nga këto analiza dhe raporte, në fillim të çdo viti akademik hartohet nga njësitë bazë plani i aktiviteteve për vitin në vijim.

Një tjetër proces vetëvlerësues auditimi i brendshëm është edhe ai i cili zhvillohet nga një komision (*ad-hoc*) i ngritur nga rektori. Ky komision auditon njësitë akademike dhe administrative mbi ligjshmërinë e administrimit të dokumentacionit të brendshëm. Në rast mospërputhshmërie me dispozitat statutoare dhe të rregulloreve, grupi i punës u ngarkon detyrat përkatëse njësitë për t'i plotësuar konform kuadrin ligjor përkatës. Një praktikë e tillë mund të vërehet në Evidencën nr. 29.³⁸


Varësisht rezultateve të vlerësimeve periodike të formave të ndryshme të vetëvlerësimit të përmendura mësipër, bëhet një shpërndarje e çështjeve që kërkojnë përmirësim, ose zhvillim të mëtejshëm varësisht zyrave përkatëse dhe më pas ri-auditohet nga komisioni përkthës *ad hoc*.

Në lidhje me çështjet e infrastrukturës dhe shërbimeve logjistike, KUB i ato duke realizuar çdo vit një anketë, e cila i drejtohet personelit akademik, administrativ dhe studentëve, në lidhje me cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni dhe çfarë duhet të përmirësojnë më tej.

KUB, që nga themelimi i tij në vitin 2011 e deri më sot ka kaluar me sukses dy procese akreditimi institucional, i pari në vitin 2013 dhe i dyti më vitin 2017. Të dy këto procese kanë kaluar me sukses dhe

³⁷ Evidenca nr. 10: Model i raportit vjetor

³⁸ Evidenca nr. 29: Praktikë e auditimit të brendshëm:



institucioni, varësisht sugjerimeve të ekspertëve të jashtëm ka marrë masa për plotësimin e tyre. Në përgjigje të këtyre rekomandimeve, KUB ka dërguar pranë MASR dhe ASCAL planin e veprimit për zbatimin e tyre në për të gjitha programet, duke përfshirë këtu edhe BA në Shkenca Komunikimi.³⁹

Gjithashtu, Programi i Studimit BA në Shkenca Komunikimi ka kaluar me sukses akreditimin në vitin 2013, duke marrë vlerësim maksimal për gjashtë vite. Masat e marra në lidhje me sugjerimet e ekspertëve të jashtëm janë përshkruar në pjesën hyrëse të këtij raporti dhe në planin e sipërpërmendur

Një tjetër vlerësim i jashtëm ka qenë edhe ai i kërkuar nga KUB prej një eksperti të jashtëm.⁴⁰

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin</p>	<p>Kriteri 1: Me qëllim vlerësimin akademik dhe zhvillimin e cilësisë, pranë KUB është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit, të cilët kanë dhe faqen e tyre zyrtare Web. (www.qac.beder.edu.al). Funkcionimi dhe kompetencat e tyre janë të specifikuar në rregulloret përkatëse, si dhe të shprehura në statut. Në këto kompetenca përfshihet zhvillimi dhe monitorimi i anketës që realizohet nga ana e studentëve për personelin akademik dhe përmbajtjen e lëndëve.</p> <p>Vlerësimi i efektshmërisë së pedagogëve bëhet përmes disa mënyrave, e cila rregullohet sipas rregullores së anketave dhe vlerësimit.</p> <p>Pedagogët vlerësohen përmes anketimeve të studentëve, vetëvlerësimit të tyre, si edhe vlerësimit të eprorit brenda njësisë.</p> <p>Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura, studentët japin mendimin e tyre për pedagogun dhe brendinë e lëndës. Kjo anketë realizohet para provimit përfundimtar të çdo semestri.⁴¹</p> <p>Vlerësimi i studentëve për pedagogun dhe brendinë e lëndës është objekt i diskutimit për përmirësimin e lëndës në vitin pasardhës, duke bërë p.sh. ndryshime në format e vlerësimit, tekstet përkatëse, materiale plotësuese, deri në ndryshimin e pedagogut përkatës për zhvillimin e lëndës. Zyra e kurrikulave funksionon sipas një rregulloreje dhe procedure të miratuar nga Senati Akademik, tregon rëndësinë që i kushtohet përmirësimit të programeve.⁴²</p> <p>Kriteri 2: KUB i përfshin këto ndryshime si në materialet vetëvlerësuese, po ashtu edhe në raportin vjetor institucional që</p>

³⁹ Evidenca nr. 36: Plan veprimi për rekomandimet e lëna nga akreditimi i mëparshëm për programin

⁴⁰ Evidenca nr. 37: Raport i vlerësimit të jashtëm kërkuar nga IAL

⁴¹ Evidenca nr. 17: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

⁴² Evidenca nr. 38: Udhëzimi mbi procesin e zhvillimit të kurrikulave



<p>institucional;</p> <p>Kriteri 3. Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4. Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>d. Testime paraprake dhe finale; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj.</p>	<p>dërgon në çdo fund viti akademik pranë MASR.</p> <p>Kriteri 3: KUB publikon rezultatet e vlerësimit të aktorëve të ndryshëm brenda institucionit, (student, personel akademik dhe administrativ) në faqen e internetit të tij. Përsa u përket rezultateve të pritshme, KUB ka bërë publik planin strategjik institucional për periudhën 2012-2017, si edhe planin e ri strategjik për periudhën 2018-2023⁴³.</p> <p>Kriter 4: Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimeve. Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura, studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe brendinë e lëndës. Bashkëngjitur është edhe modeli i anketimit të zhvilluar.⁴⁴</p> <p>Programet e studimeve përmirësohen duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët.</p> <p>Metodat e tërthorta të vlerësimit janë implementuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë me seksione të veçanta mbi:</p> <p>a. Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës</p> <p>b. Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës.</p> <p>c. Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga KUB</p> <p>d. Pyetje konceptuale</p> <p>e. Rekomandime nga studentët</p> <p>Metoda të drejtpërdrejta janë ato të të përfshira edhe në syllabus-in e lëndës si:</p> <p>a) Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor;</p> <p>b) Vlerësime me notë dhe me pikë;</p> <p>c) Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët;</p> <p>d) Vlerësim për përfshirjen në aktivitete jashtë-shkollore;</p> <p>e) Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës;</p> <p>f) Vlerësime të studentëve nga njëri-tjetri për nivelin dhe formën e angazhimit të tyre në punë e projekte të realizuara në grup;</p> <p>g) Vlerësime për testime ndërmjetëse të semestrit përkatës;</p> <p>h) Vlerësime për testime finale në përfundim të semestrit.</p>
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1. Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>Kriteri 1 KUB ka kaluar me sukses 2 akreditime institucionale, të parin në vitin 2013 nga APAAL dhe të dytin në vitin 2017 nga agjensia britanike e akreditimit "Quality Assurance Agency", në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Kriteri 2: Në përputhje me kuadrin ligjor të brendshëm dhe të jashtëm, KUB për Vlerësimin akademik dhe zhvillimin e cilësisë ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si edhe dy komisione të përhershme: Komisioni i përhershëm për</p>

⁴³ Evidenca nr. 39: Vendim i senatit për miratimin e planit strategjik 2018-2023

⁴⁴ Evidencë nr. 19: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

Kriteri 3. Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4. Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5. Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6. Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin dhe Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.⁴⁵

Kriteri 3: Nga kompetencat e NJSBC dhe dy komisioneve të përhershme të përmendura më sipër është edhe zhvillimi i strategjive dhe i planeve vlerësuese për personelin akademik. Siç u përmend edhe në pjesën përshkrimore, në fund të çdo viti akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të personelit akademik, rezultati i të cilit dorëzohet nëpërmjet një zarfi të mbyllur.

Kriteri 4: Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i Kolegjit Universitar “Bedër” që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht. Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore përcillen për në Senat duke pasur parasysh parimin hierarkik vertikal: departament - fakultet - rektorat. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së menaxhimit të kurrikulave.

Kriteri 5: KUB synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Për këtë arsye, vazhdimisht realizohen takime orientuese dhe informuese si dhe janë vënë në dispozicion të studentëve dhe të personelit Manuali i Sigurimit të Cilësisë, si edhe Guida e Studentëve⁴⁶ dhe ajo e personelit⁴⁷, ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe siguri i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Kriteri 6: Senati i KUB, pas diskutimesh në plan të gjerë me të gjitha njësitë, në vitin 2012 ka miratuar planin strategjik 5-vjeçar të institucionit. Ky plan strategjik, në përmbushje të misionit të institucionit, synonte zhvillimin në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri.

Strategjia e institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e KUB. Aktualisht institucioni ka miratuar planin e ri strategjik për periudhën 2018-2023, në hartimin e të cilit morën pjesë përfaqësues të rektoratit, departamenteve, njësive kryesore, si edhe përfaqësues të studentëve të diplomuar dhe senatit studentor, për të siguruar një përfaqësim sa më të plotë e gjithëpërfshirës.

Të dy planet strategjike janë të aksesueshme për këdo përmes faqes zyrtare të institucionit.

⁴⁵ Evidenca nr. 40: Vendim senati për miratim e ngritjes së komisioneve të përhershme

⁴⁶ Evidenca nr. 41: Guida e Studentit

⁴⁷ Evidenca nr. 42: Guida e Personelit


Konkluzione të GVB:

Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të departamentit diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara dhe e miratoi atë me konsensus. Institucioni dëshmon se përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve, duke përdorur metoda të thërthorta dhe të drejtpërdrejta. Informacion i mbledhur përmes metodave të mësipërme përfshihet në vetëvlerësimin institucional si dhe në marrjen e masave për përmirësimin e rezultateve të mëtejshme.

Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar dy herë në nivel institucional përpara aplikimit për ri-akreditimin e programeve të studimeve.

Gjithashtu, institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, të cilën e publikon duke synuar ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to si dhe përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë duke hartuar një politikë të qartë dhe ndjekur procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen nëpërmjet mekanizmave formalë për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron.

GVB konstaton se programi “Bachelor” në Shkenca Komunikimi i **përbush plotësisht** kriteret e kërkuara.



POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit/eve të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj.

Misioni

Misioni i Departamentit të Shkencave të Komunikimit është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e gazetarisë, e komunikimit, e marrëdhënies publike dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si edhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, në përputhje edhe me zhvillimet e teknologjisë bashkëkohore, në fushën e mediave të reja.

Vizioni

Departamenti i Shkencave të Komunikimit do të sjellë risi në mënyrën e aftësisë dhe të përgatitjes së studentëve nëpërmjet një gërshetimi të mirorganizuar të anës teorike me praktikën në kushte dhe mundësi fizike bashkëkohore. Duke u bazuar në një personel akademik të përkushtuar në misionin e tij, departamenti do të nxisë te studentët dashurinë dhe respektin për vendin e tyre dhe do të mbështesë angazhimin e gjithsecilit për një shtyp të lirë dhe të pavarur, për një komunikim transparent e të ndershëm sipas parimeve të deontologjisë e etikës profesionale.

Mundësitë e punësimit

Studenti mund të punojë në institucione mediatike publike e private, si gazetar i medias së shkruar, si reporter, si gazetar politik etj.

Studenti mund të punojë në organizma, organizata e shoqata vendase dhe të huaja, të cilat operojnë në fushën e edukimit/komunikimit, shërbimeve, edukatës qytetare dhe si operator e kurator i marrëdhënies ndërkombëtare, në administratën publike e private etj.

Studenti mund të punojë, gjithashtu në organet drejtuese të medias së shkruar apo vizive.

Studenti mund të punojë në subjekte politike, në zyrat e shtypit dhe të informimit, të marrëdhënies me publikun, në institucione të huaja, organizma të huaj etj.

Tregues të matshëm:


Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Departamenti i Shkencave të komunikimit nisi aktivitetin e tij mësimor në vitin akademik 2011-2012, me dy programe studimi:

1. “Bachelor” në Shkenca komunikimi
2. “Master i shkencave” në Shkencave Komunikimi, profili *Gazetari* dhe profili *Marrëdhënie publike*

Duke paraqitur para studentëve programe të kompletuara me të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë profesionale në Shkencat e Komunikimit, *Gazetari* në mjete të ndryshme komunikimi dhe *Marrëdhënie publike*, mbetemi të angazhuar në misionin tonë: për të edukuar, për të zgjeruar njohuritë rreth fushës të mbështetura në baza të etikës profesionale, përgatitje të studentëve në hartimin e kujdesshëm të mënyrave të analizimit të fakteve dhe situatave të ndryshme, shkrimi saktë i informacionit dhe dhënia studentëve e një kulture të gjerë pluraliste në mënyrën e mendimit dhe konceptimit të situatave.

Si një departament i bazuar në preferenca profesionale dhe me synimin për të përgatitur qytetarët për të qenë pjesë e një shoqërie demokratike, ne kërkojmë të përmbushim misionin tonë, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikojnë qartë, të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që



ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që zotëron transmetimi i informacionit në mediat e një shoqërie të lirë, si dhe rëndësinë e veçantë që kanë marrëdhëniet me publikun brenda institucioneve publike dhe private.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe provimet finale
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe provimin final
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 50'⁴⁸

Emërtimi i Diplomës për programin e studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi

KUB pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi brenda afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me diplomën përkatëse e cila është dokument zyrtar. Diplomat për ciklin e parë shoqërohen me suplementin e diplomës, i cili hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë dhe përshkruan në veçanti natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës, etj.


Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati Akademik, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.⁴⁹

Çdo formë diplome ose çertifikate, përpara se të lëshohet, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që mbahet në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Të gjithë ata studentë që përfundojnë me sukses studimet e ciklit të parë në programin “Bachelor” në shkenca komunikimi, pajisen me diplomë: **“Bachelor” në Shkenca Komunikimi.**

⁴⁸ Shënim: Kohëzgjatja e një ore mësimore deri në vitin akademik 2017-2018 ka qenë varësisht udhëzimit të MASR, 60 minuta. Me ndryshimet e reja ligjore, kohëzgjatja e një ore mësimore është 50 minuta.

⁴⁹ Evidenca nr. 43: Model diplome dhe suplementi



Plani mësimor sipas modelit të tabelës 13

Tabela 12: Plani mësimor Viti I

Viti I Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Gjithsej			
				Leksione		Seminare		Laborator		Praktikë		Orë në auditor		Punë e pavarur			Provimi		
				ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	Orë në auditor	Punë e pavarur	Provimi	
1	Gjuhë shqipe I	5	4	5	64	41	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	41	20	125
2	Hyrie në sociologji	4	3	4	48	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	30	22	100
3	Psikologji sociale	4	3	4	48	32	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	32	20	100
4	Histori e Shqipërisë	4	3	4	48	27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	27	25	100
5	Hyrie në komunikim masiv	4	3	4	48	29	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	29	23	100
6	Marrëdhënie publike	4	3	4	48	28	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	28	24	100
7	Anglisht I / Anglisht e avancuar	5	5/5	5/5	0/0	0/0	0	80/80	15/15	0	0	0	0	0	0	80	15	30	125
8	Gjuhë shqipe II	5	4	5	64	41	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	41	20	125
9	Historia e medias	5	3	5	48	52	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	52	25	125
10	Teoritë e komunikimit	5	3	5	48	52	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	52	25	125
11	E drejta kushtetuese	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
12	Hyrie në Informatikë	5	3	5	48	53	0	0	0	0	0	0	0	0	0	48	53	24	125
13	Anglisht I / Anglisht e avancuar	5	5/5	5/5	0/0	0/0	0	80/80	15/15	0	0	0	0	0	0	80	15	30	125
Total		60	45	60	560	442		160	30							720	472	308	1500

Tabela 13: Plani mësimor Viti II

Viti II Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Ore në javë	Ore mësimore												Gjithsej		
				Leksione				Seminare		Laborator		Praktikë			Punë e pavarur		Punë e pavarur	
				ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor				Punë e pavarur
1	I	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
2	I	5	3	5	48	52	0	0	0	0	0	0	0	0	48	52	25	125
3	I	5	3	5	48	55	0	0	0	0	0	0	0	0	48	55	22	125
4	I	5	5	3	48	13	2	32	12	0	0	0	0	0	80	25	20	125
5	I	5	3	5	48	59	0	0	0	0	0	0	0	0	48	59	18	125
6	I	5	3	5	48	62	0	0	0	0	0	0	0	0	48	62	15	125
7	II	5	5	3	48	13	2	32	12	0	0	0	0	0	80	25	20	125
8	II	5	3	5	48	59	0	0	0	0	0	0	0	0	48	59	18	125
9	II	5	3	5	48	55	0	0	0	0	0	0	0	0	48	55	22	125
10	II	5	3	5	48	52	0	0	0	0	0	0	0	0	48	52	25	125
11	II	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
12	II																	
13	II	5	3	5	48	42	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
14	II	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
Total		60	40	56	576	591	4	64	24	0	0	0	0	0	640	615	245	1500


Tabela 14: Plani mësimor Viti III

Viti III Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore															
				Leksione		Seminare		Laborator		Praktikë		Orë në auditor		Provimi					
				ECTS	Në auditor	P.unë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	Orë në auditor	Punë e pavarur	Provimi	Gjithsej
1	Hyria në analizë ligjërimit	1	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
2	Etika e medias dhe legjislacioni	1	5	3	5	48	59	0	0	0	0	0	0	0	0	48	59	18	125
3	Metodat e kërkimit & Shkrimin akademik	1	5	3	5	48	55	0	0	0	0	0	0	0	0	48	55	22	125
4	Praktikë profesionale	1	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
5	Marketing mediatik	1	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
6	Lëndë me zgjedhje																		
7	Komunikim organizativ	1	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
8	Komunikimi ndërkulturor dhe ndërpersonal	1	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
9	Historia e integritetit dhe institucionet e BE-së	1	5	3	5	48	57	0	0	0	0	0	0	0	0	48	57	20	125
10	Punimi i diplomës	11	6	3	0	0	0	6	48	82	0	0	0	0	0	48	82	20	150
11	E folura në publik	11	6	3	6	48	77	0	0	0	0	0	0	0	0	48	77	25	150
12	Teoritë e përkthimit	11	6	3	6	48	82	0	0	0	0	0	0	0	0	48	82	20	150
13	Intervistimi	11	6	3	6	48	82	0	0	0	0	0	0	0	0	48	82	20	150
14	Lëndë me zgjedhje	11																	
	Historia e mendimit politik	11	6	3	6	48	82	0	0	0	0	0	0	0	0	48	82	20	150
	Historia e civilizimeve		6	3	6	48	82	0	0	0	0	0	0	0	0	48	82	20	150
	Hyrie në marrëdhënie ndërkombëtare		6	3	6	48	82	0	0	0	0	0	0	0	0	48	82	20	150
	Komunikim politik		6	3	6	48	82	0	0	0	0	0	0	0	0	48	82	20	150
	Menaxhimi i burimeve njerëzore		6	3	6	48	82	0	0	0	0	0	0	0	0	48	82	20	150
	Total		60	33	54	480	665	6	48	82	0	0	0	0	0	528	747	225	1500

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:


- Leksionet _____ 1568 orë në auditor dhe _____ 1641 orë punë e pavarur e studentit
- Seminarat _____ 272 orë në auditor dhe _____ 136 orë punë e pavarur e studentit
- Laboratorët _____ orë në auditor dhe _____ orë punë e pavarur e studentit
- Praktikatat lëndore _____ 48 orë në auditor dhe _____ 57 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale _____ orë në auditor dhe _____ orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar _____ 72 orë në auditor dhe _____ 706 orë punë e pavarur e studentit

Të dhënat e mësipërme mund të gjenden në pjesën e fundit të syllabuseve të çdo lënde.



Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F)
Tabela 15: Plani mësimor sipas veprimtarive formuese

PLANI MËSIMOR "BACHELOR NË SHKENCA KOMUNIKIMI"			
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	Hyrje në komunikim masiv	4	29
	Teoritë e komunikimit	5	
	Bazat e semiotikës	5	
	Filozofi komunikimi	5	
	Elementët e komunikimit	5	
	Metodat e kërkimit & Shkrim akademik	5	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Gjuhë shqipe I	5	91
	Histori e Shqipërisë	4	
	Marrëdhënie publike	4	
	Gjuhë shqipe II	5	
	Historia e medias	5	
	E drejta kushtetuese	5	
	Shkrim dhe raportim lajmi I	5	
	Gazetari ekonomike	5	
	Shkrim dhe raportim lajmi II	5	
	Statistikë për shkencat sociale	5	
	Metodat e redaktimit	5	
	Agjensitë e lajmeve	5	
	Hyrja në analizë ligjërimiti	5	
	Etika e medias dhe legjislacioni	5	
	Marketing mediatik	5	
	E folura në publik	6	
Teoritë e përkthimit	6		
Intervistimi	6		
Veprimtari në disiplina të ngjashme dhe/ose integruese (C)	Hyrje në sociologji	4	18
	Psikologji sociale	4	
	Hyrje në shkenca politike	5	
	E drejta publike	5	
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Shtypi i shkruar dhe online	5	16
	Foto imazhi	5	
	Komunikim organizativ	5	
	Komunikimi ndërkulturor dhe ndërpersonal	5	
	Historia e mendimit politik	6	
	Historia e civilizimeve	6	
	Hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare	6	
	Komunikim politik	6	
Menaxhimi i burimeve njerëzore	6		
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	Hyrje në Informatikë	5	20
	Gjuhë e huaj 1	5	
	Gjuhë e huaj 2	5	
	Praktikë profesionale	5	
Teza e diplomës (F)	Punimi i diplomës	6	6



Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programin e licensuar

Tabela 16: Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programin e licensuar

Viti I (Viti II) (Viti III)	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	Provime
					Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë						
					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1	Lënda 1 (ishte)																			
	Lënda 1 (u ndryshua)																			
2	Lënda 2 (ishte)																			
	Lënda 2 (u ndryshua)																			
	...																			
	...																			
Ndryshime në total																				

Shënim: Gjatë periudhës 2013-2018 nuk janë realizuar ndryshime në planin mësimor krahasuar me programin e licensuar. Si pasojë e informacionit të marrë nga një studim i detajuar tregu i realizuar nga një grup pune i ngritur brenda personelit të Departamentit të Shkencave të Komunikimit dhe që përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra, numrin e kërkesave të maturantëve për këto programe, dhe varësisht sugjerimeve të bëra nga ky studim, Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka dorëzuar pranë institucioneve shtetërore (Ministrisë respektive) dosjen për riorganizim të programit të studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi dhe çelje të programeve të reja.⁵⁰

 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës
Tabela 17: Plani mësimor i lidhur me personelin akademik sipas viteve

Viti akademik 2013-2014

Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1 Gjuhë shqipe I	Rahim Ombashi Jolanda Lila Belfjore Qose	Prof.As.Dr Doktorante PhD	Shkenca Komunikimi	4	PAE PAK PAK
2 Hyrje në komunikim masiv	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
3 Hyrje në sociologji	Genti Kruja	Dr.	Shkenca Islame	3	PAE
4 Psikologji sociale	Skender Brucaj	Doktorant	Shkencat e Edukimit	3	PAE
5 Histori e Shqipërisë	Hasan Bello	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
6 Marrëdhënie publike	Alban Tartari	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
7 Anglisht I	Anita Neziri	Doktorant	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAK
8 Anglisht e avancuar	Carly Reci	MSc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
9 Gjuhë shqipe II	Rahim Ombashi	Prof.as.dr.	Shkenca Komunikimi	4	PAE
10 Historia e medias	Mark Marku	Prof.as.dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
11 Teoritë e komunikimit	Arta Sakja	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
12 E Drejta kushtetuese	Bledar Maksuti	LLM	Shkenca Komunikimi	3	PAK
13 Hyrje në informatikë	Abdurrahman Celebi	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE

⁵⁰ Evidenca nr. 44: Shkresë për dorëzimin e dosjes për riorganizim të programit të studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi dhe çelje të programeve të reja.

14	Shtypi i Shkruar dhe online	Rudi Dunga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
15	Gazetari Ekonomike	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
16	Filozofi Komunikimi	Bashkim Gjergji	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
17	Bazat e semiotikës	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
18	Shkrim dhe raportim lajmi I	Rudi Dunga Fatos Hakorja	MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 2	PAE PAK
19	Hyrje në shkenca politike	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	3	PAE
20	E drejta publike	Ada Guven	Doktorant	Drejtësi	3	PAE
21	Statistikë për shkencat sociale	Besa Shahini	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
22	Metodat e redaktimit	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
23	Shkrim dhe raportim lajmi II	Roland Zili	MSc.	Shkenca Komunikimi	2	PAK
24	Agjensitë e lajmeve	Briseida Mema	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
25	Elementët e komunikimit	Aleksander Cipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
26	Etika e Medias dhe legjisllacioni	Briseida Mema	Prof.Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
27	Metodat e kërkimit dhe shkrimi akademik	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
28	Marketing Mediatik	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
29	Praktikë Profesionale	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
30	Hyrje në analizë ligjërimiti	Dhurata Shehri	Prof. Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
31	E folura në publik	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
32	Intervistimi	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
33	Bazat e teorive të përkthimit	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
34	Punimi i diplomës	Ilda Shytaj Erlis Çela Rudi Dunga Emirjon Senja Ramadan Çipuri Rahim Ombashi Briseida Mema	Doktorante Doktorant Msc Doktorant Doktorant Prof.As.Dr Prof. Dr	Shkenca Komunikimi	1 1 1	PAE PAE PAE PAE PAE PAE
35	Komunikim Organizativ	Gentiana Skura	Prof. As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
36	Komunikimi Ndërkulturor dhe Ndërpersonal					
37	Historia e Civilizimeve					
38	Komunikim Politik	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
39	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore					
40	Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare					
41	Historia e Integritimit dhe Institucionet e BE-së					
42	Historia e Mendimit Politik					

Viti akademik 2014-2015

Lënda /Moduli	Pedagogu/ Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1. Gjuhë shqipe I	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE

2.	Hyrje në komunikim masiv	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
3.	Hyrje në sociologji	Genti Kruja Ilda Shytaj	Dr. Doktorant	Shkenca Islame Shkenca Komunikimi	3	PAE PAE
4	Psikologji sociale	Ilda Shytaj Fatih Ufuk Bagci	Doktorant Doktorant	Shkenca Komunikimi Gjuhë dhe Letërsi Turke	3	PAE PAE
5	Histori e Shqipërisë	Ilirjana Kaceli	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
6	Marrëdhënie publike	Alban Tartari	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
7	Anglisht I	Arti Omeri Mehmet Arslan	Doktorant PhD	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
8	Anglisht e avancuar	Carly Recı	MSc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
9	Gjuhë shqipe II	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE
10	Historia e medias	Mark Marku	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
11	Teoritë e komunikimit	Ilda Shytaj	Doktorante	Shkenca Komunikimi	3	PAE
12	E Drejta kushtetuese	Bledar Uku Irvin Faniko Kelmend Nezha	MSc. Doktorant Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE PAE PAE
13	Hyrje në informatikë	Arben Malasi	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
14	Shtypi i Shkruar dhe online	Rudi Dunga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
15	Gazetari Ekonomike	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
16	Filozofi Komunikimi	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
17	Bazat e semiotikës	Agron Tufa	Doc.Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
18	Shkrim dhe raportim lajmi I	Rudi Dunga Fatos Hakorja	MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 2	PAE PAK
19	Hyrje në shkenca politike	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejhtësi	3	PAE
20	E drejta publike	Arjan Lame	PhD	Drejhtësi	3	PAE
21	Statistikë për shkencat sociale	Edlira Mali	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
22	Metodat e redaktimit	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
23	Shkrim dhe raportim lajmi II	Roland Zili	MSc.	Shkenca Komunikimi	2	PAK
24	Agjensitë e lajmeve	Briseida Mema	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
25	Elementët e komunikimit	Aleksander Cipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
26	Etika e Medias dhe legjislacioni	Briseida Mema	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
27	Metodat e kërkimit dhe shkrimi akademik	Klodian Shehi	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
28	Marketing Mediatik	Erlis Cela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
29	Praktikë Profesionale	Rudi Dunga Emirjon Senja	MSc. Doktorant.	Shkenca Komunikimi	3 3	PAE PAE
30	Hyrje në analizë ligjërimit	Dhurata Shehri	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
31	E folura në publik	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
32	Intervistimi	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
33	Bazat e teorive të përkthimit	Agron Tufa	Doc.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
34	Punimi i diplomës	Edlira Mali Emirjon Senja Rudi Dunga Ilda Shytaj	PhD Doktorant MSc. Doktorant	Shkenca Komunikimi	1 1 1 1	PAE PAE PAE PAE
35	Komunikim Organizativ	Gentiana Skura	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
36	Komunikimi Ndërkulturor dhe Ndërpersonal	Klodian Shehi	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK

37	Historia e Civilizimeve					
38	Komunikim Politik	Edlira Mali	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
39	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore					
40	Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare	Klodian Shehi	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
41	Historia e Integritimit dhe Institucionet e BE-së	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
42	Historia e Mendimit Politik					


Viti akademik 2015-2016

Lënda /Moduli		Pedagogu/ Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1.	Gjuhë shqipe I	Rahim Ombashi Brikena Smajli Monika Hasani	Prof.As.Dr PhD Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE PAK PAK
2.	Hyrje në komunikim masiv	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
3.	Hyrje në sociologji	Genti Kruja Ilda Shytaj	Dr. Doktorant	Shkenca Islame Shkenca Komunikimi	3	PAE PAE
4	Psikologji sociale	Fatih Ufuk Bagci Ilda Shytaj	Doktorant Doktorante	Gjuhë dhe letërsi Turke Shkenca Komunikimi	3	PAE PAE
5	Histori e Shqipërisë	Ilijana Kaceli	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
6	Marrëdhënie publike	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
7	Anglisht I	Enkeleda Jata Morena Citozi	PhD Doktorante	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE PAK
8	Anglisht e avancuar	Enkeleda Jata Elona Vrenezi	PhD Doktorante	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE PAK
9	Gjuhë shqipe II	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE
10	Historia e medias	Mark Marku	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
11	Teoritë e komunikimit	Ilda Shytaj	Doktorante	Shkenca Komunikimi	3	PAE
12	E Drejta kushtetuese	Enkelejd Alibeaj Bledar Uku	MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK PAE
13	Hyrje në informatikë	Migena Luga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
14	Shtypi i Shkruar dhe online	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
15	Gazetari Ekonomike	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
16	Filozofi Komunikimi	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
17	Bazat e semiotikës	Agron Tufa	Doc.Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
18	Shkrim dhe raportim lajmi I	Rudi Dunga Fatos Hakorja	MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 2	PAE PAK
19	Hyrje në shkenca politike	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	3	PAE
20	E drejta publike	Bledar Uku Ada Guven Kelmend Nezha	MSc. Doktorant Doktorant	Drejtësi	3	PAE PAE PAE
21	Statistikë për shkencat sociale	Edlira Mali	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
22	Metodat e redaktimit	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
23	Shkrim dhe raportim lajmi II	Roland Zili	MSc.	Shkenca Komunikimi	2	PAK
24	Agjensitë e lajmeve	Briseida Mema	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
25	Elementët e komunikimit	Aleksander Cipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
26	Etika e Medias dhe legjislacioni	Briseida Mema	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE

27	Metodat e kërkimit dhe shkrimi akademik	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
28	Marketing Mediatik	Erlis Cela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
29	Praktikë Profesionale	Rudi Dunga Emirjon Senja	MSc. Doktorant	Shkenca Komunikimi	3 3	PAE PAE
30	Hyrje në analizë ligjërimiti	Dhurata Shehri	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
31	E folura në publik	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
32	Intervistimi	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
33	Bazat e teorive të përkthimit	Agron Tufa	Doc.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
34	Punimi i diplomës	Rudi Dunga Ramadan Çipuri Emirjon Senja Erlis Çela	MSc. Doktorant Doktorant Doktorant	Shkenca Komunikimi	1 1 1 1	PAE PAE PAE PAE
35	Komunikim Organizativ	Gentiana Skura	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
36	Komunikimi Ndërkulturor dhe Ndërpersonal					
37	Historia e Civilizimeve					
38	Komunikim Politik	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
39	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore					
40	Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare					
41	Historia e Integritimit dhe Institucionet e BE-së					
42	Historia e Mendimit Politik					

Viti akademik 2016-2017

Lënda /Moduli		Pedagogu/ Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1.	Gjuhë shqipe I	Rahim Ombashi Ana Cuka	Prof.As.Dr MSc	Shkenca Komunikimi	4	PAE PAE
2.	Hyrje në komunikim masiv	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
3.	Hyrje në sociologji	Genti Kruja Hysni Skura	Dr. MSc.	Shkenca Islame Shkenca Islame	3	PAE PAE
4	Psikologji sociale	Erilda Ajazi Kasim Ilhan	MSc MSc	Shkencat e Edukimit Shkenca Islame	3	PAE PAE
5	Histori e Shqipërisë	Ilijana Kaceli	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
6	Marrëdhënie publike	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
7	Anglisht I	Zamira Hodo	MSc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
8	Anglisht e avancuar	Enkeleda Jata	PhD	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
9	Gjuhë shqipe II	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE
10	Historia e medias	Mark Marku	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
11	Teoritë e komunikimit	Aleksander Cipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
12	E Drejta kushtetuese	Enkelejd Alibeaj	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
13	Hyrje në informatikë	Klevis Topi	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
14	Shtypi i Shkruar dhe online	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
15	Gazetari Ekonomike	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
16	Filozofi Komunikimi	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE




17	Bazat e semiotikës	Agron Tufa	Doc.Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
18	Shkrim dhe raportim lajmi I	Rudi Dunga Fatos Hakorja	MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 2	PAE PAK
19	Hyrje në shkenca politike	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	3	PAE
20	E drejta publike	Bledar Uku Enkelejd Alibeaj	MSc. MSc.	Drejtësi	3	PAE PAK
21	Statistikë për shkencat sociale	Edlira Mali	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
22	Metodat e redaktimit	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
23	Shkrim dhe raportim lajmi II	Rudi Dunga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
24	Agjensitë e lajmeve	Briseida Mema	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
25	Elementët e komunikimit	Aleksander Cipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
26	Etika e Medias dhe legjislacioni	Briseida Mema	Prof.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
27	Metodat e kërkimit dhe shkrimi akademik	Ramadan Çipuri	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
28	Marketing Mediatik	Edlira Mali	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
29	Praktikë Profesionale	Edlira Mali Rudi Dunga Ramadan Çipuri Erlis Cela	PhD MSc. Doktorant Doktorant	Shkenca Komunikimi	3 3 3 3	PAE PAE PAE PAE
30	Hyrje në analizë ligjërimit	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
31	E folura në publik	Ramadan Çipuri	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAK
32	Intervistimi	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
33	Bazat e teorive të përkthimit	Agron Tufa	Doc.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
34	Punimi i diplomës	Edlira Mali Rudi Dunga Erlis Çela Ramadan Çipuri	PhD MSc. Doktorant Doktorant	Shkenca Komunikimi	1 1 1 1	PAE PAE PAE PAE
35	Komunikim Organizativ	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
36	Komunikimi Ndërkulturor dhe Ndërpersonal					
37	Historia e Civilizimeve					
38	Komunikim Politik	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
39	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore					
40	Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare					
41	Historia e Integritimit dhe Institucionet e BE-së	Erlis Çela	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
42	Historia e Mendimit Politik					

Viti akademik 2017-2018

Lënda /Moduli	Pedagogu/ Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK	
1.	Gjuhë shqipe I	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE
2.	Hyrje në komunikim masiv	Ramadan Çipuri	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
3.	Hyrje në sociologji	Genti Kruja	Dr.	Shkenca Islame	3	PAE
4	Psikologji sociale	Erilda Ajazi Fatih Ufuk Bagci	MA Dr.	Shkencat e Edukimit	3	PAE PAE
5	Histori e Shqipërisë	Ilirjana Kaceli	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK

6	Marrëdhënie publike	Erlis Çela	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
7	Anglisht I	Zamira Hodo	MSc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
8	Anglisht e avancuar	Zamira Hodo	MSc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
9	Gjuhë shqipe II	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE
10	Historia e medias	Mark Marku	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
11	Teoritë e komunikimit	Erlis Çela	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
12	E Drejta kushtetuese	Enkelejd Alibeaj	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
13	Hyrje në informatikë	Migena Luga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
14	Shtypi i Shkruar dhe online	Jola Marku	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
15	Gazetari Ekonomike	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
16	Filozofi Komunikimi	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
17	Bazat e semiotikës	Agron Tufa	Doc.Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
18	Shkrim dhe raportim lajmi I	Rudi Dunga Fatos Hakorja	MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 2	PAE PAK
19	Hyrje në shkenca politike	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejhtësi	3	PAE
20	E drejta publike	Ermira Shkreta Bledar Uku	MSc. MSc.	Drejhtësi	3	PAE PAE
21	Statistikë për shkencat sociale	Edlira Mali	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
22	Metodat e redaktimit	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
23	Shkrim dhe raportim lajmi II	Rudi Dunga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
24	Agjensitë e lajmeve	Rudi Dunga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
25	Elementët e komunikimit	Jola Marku	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
26	Etika e Medias dhe legjislacioni	Mentor Kikia	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
27	Metodat e kërkimit dhe shkrimi akademik	Jola Marku	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
28	Marketing Mediatik	Edlira Mali	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
29	Praktikë Profesionale	Jola Marku Edlira Mali Rudi Dunga	MSc. MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 3 3	PAE PAE PAE
30	Hyrje në analizë ligjërimiti	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
31	E folura në publik	Ramadan Çipuri	Doc.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
32	Intervistimi	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
33	Bazat e teorive të përkthimit	Agron Tufa	Doc.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
34	Punimi i diplomës	Edlira Mali Jola Marku Rudi Dunga	MSc. MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	1 1 1	PAE PAE PAE
35	Komunikim Organizativ	Erlis Çela	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
36	Komunikimi Ndërkulturor dhe Ndërpersonal					
37	Historia e Civilizimeve					
38	Komunikim Politik	Erlis Çela	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
39	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore					
40	Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare					



41	Historia e Integritimit dhe Institucionet e BE-së	Erlis Çela	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
42	Historia e Mendimit Politik					

Viti akademik 2018-2019

Lënda /Moduli		Pedagogu/ Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1.	Gjuhë shqipe I	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE
2.	Hyrje në komunikim masiv	Jola Marku	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
3.	Hyrje në sociologji	Genti Kruja	Dr.	Shkenca Islame	3	PAE
4.	Psikologji sociale	Erilda Ajazi	MA	Shkencat e Edukimit	3	PAE
5.	Histori e Shqipërisë	Ilirjana Kaceli	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
6.	Marrëdhënie publike	Erlis Çela	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
7.	Anglisht I	Zamira Hodo	MSc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
8.	Anglisht e avancuar	Zamira Hodo	MSc.	Gjuhë dhe letërsi angleze	5	PAE
9.	Gjuhë shqipe II	Rahim Ombashi	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	4	PAE
10.	Historia e medias	Mark Marku	Prof.As.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
11.	Teoritë e komunikimit	Erlis Çela	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
12.	E Drejta kushtetuese	Enkelejd Alibeaj	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
13.	Hyrje në informatikë	Migena Luga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
14.	Shtypi i Shkruar dhe online	Jola Marku	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
15.	Gazetari Ekonomike	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
16.	Filozofi Komunikimi	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
17.	Bazat e semiotikës	Agron Tufa	Doc.Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
18.	Shkrim dhe raportim lajmi I	Rudi Dunga Fatos Hakorja	MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 2	PAE PAK
19.	Hyrje në shkenca politike	Ferdinand Xhaferaj	Dr.	Drejtësi	3	PAE
20.	E drejta publike	Enkelejd Alibeaj	MSc.	Drejtësi	3	PAE
21.	Statistikë për shkencat sociale	Edlira Mali	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
22.	Metodat e redaktimit	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
23.	Shkrim dhe raportim lajmi II	Rudi Dunga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
24.	Agjensitë e lajmeve	Rudi Dunga	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
25.	Elementët e komunikimit	Jola Marku	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
26.	Etika e Medias dhe legjislati	Mentor Kikia	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAK
27.	Metodat e kërkimit dhe shkrimi akademik	Ndriçim Ciroka	Dr.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
28.	Marketing Mediatik	Edlira Mali	MSc.	Shkenca Komunikimi	3	PAE
29.	Praktikë Profesionale	Jola Marku Edlira Mali Rudi Dunga	MSc. MSc. MSc.	Shkenca Komunikimi	3 3 3	PAE PAE PAE
30.	Hyrje në analizë ligjërimit	Aleksandër Çipa	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
31.	E folura në publik	Ramadan Çipuri	Doc.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAK
32.	Intervistimi	Emirjon Senja	Doktorant	Shkenca Komunikimi	3	PAE
33.	Bazat e teorive të përkthimit	Agron Tufa	Doc.Dr	Shkenca Komunikimi	3	PAE
34.	Punimi i diplomës					

35	Komunikim Organizativ	Ardita Reçi	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
36	Komunikimi Ndërkulturor dhe Ndërpësonal	Ardita Reçi	PhD	Shkenca Komunikimi	3	PAE
37	Historia e Civilizimeve					
38	Komunikim Politik					
39	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore					
40	Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare					
41	Historia e Integritimit dhe Institucionet e BE-së					
42	Historia e Mendimit Politik					

 Syllabuset për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

 Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve janë përshtatur sipas një formati të miratuar që në fillimin e aktivitetit të KUB, i cili është përmirësuar ndër vite. Syllabuset janë të organizuara në nëndarje kryesore ku përfshihet përshkrimi i lëndës dhe objektivat kryesore. Temat së bashku me literaturën përkatëse janë të përcaktuara nga pedagogët. Mënyra e organizimit dhe ndarjes së syllabuseve u mundëson pedagogëve liri akademike për përcaktimin e temave dhe organizimin e lëndës.


Në fillimin e vitit akademik departamenti organizon një workshop⁵¹ për të diskutuar përmbajtjen e syllabuse-ve, cilësinë dhe përditësimin e tyre. Syllabuset gjenden në faqen zyrtare të departamentit në website dhe mund të kontrollohen nga studentët. Syllabuset janë të përditësuara në mënyrë që t'u ofrojnë studentëve zhvillimet e fundit në fushat përkatëse të studimit.⁵² Syllabuset janë transparente në sistemin BIS dhe në website e KUB duke u ofruar studentëve mundësi për të kontrolluar gjithashtu edhe syllabuset ndër vite. Më poshtë gjendet një shembull syllabusi.

Tabela 18: Shembull syllabus lënde

TË DHËNA MBI LËNDËN							
Emri i lëndës: Teoritë e Komunikimit							
Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab.	Kredite	ECTS
COM 102	A	2	3	0	0	3.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Erlis Çela, Dr. / e hënë 15:00 – 15:30				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Shqip				
Niveli i lëndës			Bachelor				

⁵¹ Evidenca nr. 45: Shembull workshopi për përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve

⁵² Evidenca nr. 46: Lista e syllabuseve të lëndëve të programit




Lloji i lëndës		E detyrueshme
Klasa dhe orari i kursit		A 403, 10:00 – 12:50
Përshkrimi	Kjo lëndë i ofron studentëve një vështrim të zgjeruar mbi teoritë e komunikimit. Lëmda e teorive të komunikimit shqyrton perspektiva teorike kryesore mbi proceset e komunikimit. Studentët do të njihen me përfaqesjet objektive dhe interpretuese ndaj komunikimit. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të njihen me shtatë traditat në fushën e teorive të komunikimit. Ata do të jenë në gjendje të klasifikojnë teoritë e ndryshme të komunikimit dhe të dallojnë pikat e përbashkëta të këtyre teorive.	
Objektivat	Gjatë kësaj lënde synohet që studentët; të zgjerojnë njohuritë e tyre rreth teorive kryesore të komunikimit, të zhvillojnë cilësitë analitike për të analizuar secilin nga teoritë e komunikimit, të nxisë aplikimin e teorive të komunikimit në projekte kërkimore, të pajisë pajisen me njohuri rreth koncepteve kryesore të procesit të komunikimit që merren në shqyrtim nga teoritë e ndryshme.	
PROGRAMI I LËNDËS		
JAVA	Temat	
1.	Të flasësh për teorinë- Përfaqesja objektive dhe përfaqesja i interpretuese. Klasifikimi i teorive të komunikimit. Prezantimi i literaturës dhe burimeve bazë të lëndës, prezantimi i syllabus dhe mënyrës së vlerësimit.	
2.	Hartëzimi i territorit. Shtatë tradita në fushën e teorive të komunikimit. Përfaqesja e Robert Craig mbi shtatë traditat.	
3.	Komunikimi ndërpersonal. Ndërveprimi Simbolik. Menaxhimi i koordinuar i kuptimit	
4.	Teoria e depërtimit social. Teoria e përpunimit të informacionit social. Pikëpamja ndërvepruese.	
5.	Teoria e gjykimit social. Teoria e disonncës konitive	
6.	Komunikimi Publik dhe në grup. Komunikimi organizativ. Përfaqesja kulturore ndaj organizatave. Teoria kritike e komunikimit në organizata.	
7.	Retorika- Paradigma narrative.	
8.	Provim Gjysmëfinal	
9.	Komunikimi masiv. Ekologjia e mediave.	
10.	Teoria e kultivimit.	
11.	Përdorime dhe kënaqësi	
12.	Teoria e përcaktimi të axhendës	
13.	Teoria e përshtatjes së komunikimit	
14.	Linja të përbashkëta në teoritë e komunikimit.	
15.	Prezantim projektesh	
16.	Provimi final	
Parakushtet	Nuk ka	
Literatura	Griffin, Em; Ledbetter, Andrew; Sparks, Glen: Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit, Educational Center shpk, Tiranë, 2016	
Referenca të tjera	Ollivier, Bruno: Shkenca e komunikimit, teori dhe arritje, Papirus, Tiranë 2015 https://www.communicationtheory.org http://www.communicationstudies.com/communication-theories	
Punë laborator	Nuk ka	
Përdorimi i kompjuterit	Nuk ka	
Të tjera		
REZULTATET E LËNDËS DHE KOMPETENCAT		
1.	Në përfundim të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të njohin teoritë kryesore të komunikimit	
2.	Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi evoluimin e teorive të komunikimit në kohë dhe konceptet e reja të komunikimit	
3.	Studentët do të përfitojnë njohuri të nevojshme për të klasifikuar, analizuar dhe vlerësuar dobishmërinë e teorive të komunikimit.	
4.	Studentët do të jenë në gjendje të aplikojnë njohuritë e marra rreth teorive të komunikimit në projekte dhe studime kërkimore	
MËNYRA E VLERËSIMIT TË LËNDËS		
Notat e ndërmjetme	Sasia	Përqindja


Gjysmëfinale	1	30	
Kuize			
Projekte			
Projekte semestrare	1	20	
Pjesëmarrja		10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		60	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		40	
Total		100	
ECTS			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (Orë)	Ngarkesa totale (Orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, praktika etj.)	14	4	56
Detyra	1	0	0
Gjysmëfinale	1	10	10
Provimi final	1	15	15
Të tjera			
Ngarkesa totale e orëve			129
ECTS			5

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1. Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Kriteri 1: KUB ofron programe të akredituara në periudha të ndryshme të aktivitetit të tij. Në rastin konkret, programet e ofruara nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit, në të dyja ciklet e studimeve janë të akredituara në vitin 2013. Ky vetëvlerësim vjen në kuadër të riakreditimit të programeve të ofruara nga departamenti. Studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licensuar nga MASR.</p> <p>Kriteri 2: Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një programi “Bachelor në Shkenca Komunikimi” me kohë të plotë është 60. Kjo vërtetohet edhe nga programet e licencuara nga MASH dhe të shprehura në kurrikulën e programit, si edhe në Statutin e KUB.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1. Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p>	<p>Kriteri 1: KUB dhe Fakulteti i Shkencave Humane, si njësi e tij kryesore, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara japin në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve Bachelor që ofron. Sa më sipër, njësitë bazë kanë faqet e tyre të internetit, të cilat mund të aksesohen si në mënyrë të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe përmes faqeve të njëjësive kryesore, siç janë faqet e fakulteteve. Në këto faqe ka një paketë të gjerë transparence në lidhje me programet e studimit që ofrohen, përfshirë këtu personelin akademik, kurrikulat, sylabuset e lëndëve, këshillat e departamenteve, etj. Këto informacione mund të sigurohen edhe përmes sekretarive të</p>



<p>Kriteri 2. Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3. Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4. Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>departamentit dhe sekretarisë mësimore.</p> <p>Kriteri 2: Siç u përmend dhe më sipër, KUB dhe konkretisht Fakulteti i Shkencave Humane si njësi kryesore e tij, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara publikon në faqen e internetit në gjuhën shqipe dhe atë angleze të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron. Informacioni mund të përfitohet gjithashtu nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e departamentit.</p> <p>Kriteri 3: Siç u përmend edhe më sipër, KUB dhe Fakulteti i Shkencave Humane, si njësi e saj kryesore, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve “Bachelor” që ofron. Gjithashtu, studentët pajisen me syllabusin përkatës nga çdo lektor në fillim të semestrit. Informacioni mund të merret edhe nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e departamentit.</p> <p>Kriteri 4: Cituar edhe më sipër, KUB dhe Fakulteti i Shkencave Humane, si njësi kryesore e saj, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, publikon në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve “Bachelor” që ofron. Studentët gjithashtu pajisen me syllabusin përkatës nga çdo lektor në fillim të semestrit. Informacioni mund të përfitohet gjithashtu nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e departamentit.</p>
<p style="text-align: center;"><u>Konkluzionet e GVB:</u></p> <p>Pas përfundimit të raportit të hartuar, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të departamentit diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara dhe konstaton se standardet janë përmbushur plotësisht dhe e miratoi atë me konsensus. Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) duke u dhënë mundësi studentëve që grumbullojnë mesatarisht 60 kredite gjatë një viti akademik. Departamenti jep informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve, lëndët me zgjedhje, për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit, për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj. GVB konstaton se programi në fjalë i përmbush plotësisht kriteret e kërkuara.</p>	



MËSIMDHËNIA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së planit mësimor për çdo program. Në çdo fillim semestri miratohen ngarkesat mësimore, shpërndarja e lëndëve, mbledhja e dokumentacionit përkatës për çdo lëndë, plotësimi dhe përditësimi i programeve mësimore (syllabuseve) etj. Ky proces, në periudha të ndryshme të vitit, auditohet edhe nga një grup pune i emëruar me urdhër nga rektori.

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të teknikave të mësimdhënies, format e tyre parashikohen në programin mësimor të çdo lënde. Ato mund të jenë në formën e leksioneve, seminareve, projekteve në auditore dhe projekteve jashtë në terren, detyrave të kursit, praktikave mësimore, debateve të ndryshme, nëpërmjet leksioneve të hapura, duke ftuar profesionistë të fushave përkatëse në auditore për të zhvilluar tema specifike duke i pasuruar me të dhënat më të fundit dhe bashkëkohore, apo duke trajtuar tema të veçanta jashtë auditoreve në ambiente të institucioneve, bizneseve etj., të cilat lidhen drejtpërdrejt me tematikën përkatëse, punimi i diplomimit dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor. Shumë shpesh, studentët janë të përfshirë në përcaktimin e formave të zhvillimit të tematikave apo koncepteve të ndryshme gjatë procesit të mësimdhënies.


Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në mënyrë të vazhdueshme e shpërndarë gjatë gjithë semestrit dhe vitit akademik, duke u krijuar mundësinë studentëve që të jenë pjesë integruese dhe aktive gjatë realizimit të lëndëve mësimore. Në këtë kuadër, përdoren forma të ndryshme kontrolli dhe vlerësimi të njohurive të studentëve ku përfshihen: provimet⁵³ e ndërmjetme, provimet finale, projekte semestrale, projekte në grup, projekte individuale, detyra shtëpie dhe klase, kuice, vlerësim nga kolegët (studentët vlerësojnë angazhimin sasior dhe cilësor të kolegëve të tyre gjatë projekteve të ndryshme), prezantime individuale në grup, vlerësim për pjesëmarrjen e studentëve gjatë zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, etj. Format e kontrollit dhe vlerësimit për secilën lëndë ju bëhen të qarta studentëve në fillim të semestrit përkatës.

Vlerësimi sasior i punës së studentëve në KUB kryhet me anë të krediteve sipas sistemit amerikan dhe atij evropian të mbështetur në ECTS, kurse vlerësimi cilësor i punës së studentëve kryhet me anë të notave, të llogaritura sipas metodologjisë së përmendur në rregulloret mësimore.

KUB i kushton rëndësi të veçantë përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie. Pajisja e ambienteve mësimore me kushte kondicionimi, tabela interaktive (Smart Board), projektorë, kompjutera, karrige ortopedike etj., mundësojnë një proces mësimor cilësor. Në varësi të programeve të studimeve, disponohen kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë dhe gjuhësi. KUB është i pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor.

Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies. Duke synuar garantimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe kualifikimet e personelit në fushën e kërkimit shkencor, KUB gjatë kësaj periudhe ka organizuar disa trajnime, të cilat janë mbështetur nga NJSBC dhe zyra e burimeve njerëzore. Një listë e këtyre trajnimeve mund të gjendet në faqen e NJSBC-së. Ndërkohë, për zhvillimin e këtyre standardeve, KUB ka ngritur së fundmi Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit. Për çdo departament, për të minimizuar ngarkesat administrative të personelit akademik, është caktuar një sekretar/koordinator që ndjek punët administrative të departamentit përkatës. KUB është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Ky proces kontrollonhet periodikisht nga strukturat e brendshme të institucionit, konkretisht nga NJSBC. KUB vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve.

⁵³ Evidenca nr. 19: Rregulla mbi organizimin e provimeve



Departamenti i Shkencave të Komunikimit i kushton një rëndësi të veçantë gërshetimit të aspektit teorik me atë praktik, duke nxitur angazhimin e studentëve në të dyja mënyrat. Një game e gjerë aktiviteteve të iniciuara dhe realizuar me nismën e studentëve dhe mbështetjen e institucionit, kanë përmasa të gjëra kombëtare dhe ndërkombëtare.

Aktivitete mbështetëse të procesit mësimor

P2P Challenging Extremism

Kolegji Universitar “Bedër” me tre fushata të njëpasnjëshme, ishte pjesë e projektit P2P kundër ekstremizmit, një iniciativë e Shtëpisë së Bardhë dhe Departamentit Amerikan të Shtetit për të luftuar ekstremizmin, i cili ofron një mundësi për studentët nga Shtetet e Bashkuara, Kanada, Lindja e Mesme, Veriu Afrikës dhe Evropa për të krijuar një komunitet online për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm kudo që ai mund të ekzistojë.

Projekti u zbatua nga një ekip i studentëve nga fusha të ndryshme si komunikimi, drejtësia, marrëdhëniet ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, siguria dhe disiplina të tjera të ngjashme që krijoi një fushatë ose produkt online që trajtoi problemin e Projektit. Në kuadrin e këtij projekti, studentët organizuan një sërë takimesh ndërgjegjësuere me figura të shquara në fusha të ndryshme, në kuadër të fushatës “Paqja është Ti & Unë” dhe “Urat drejt Tolerancës”, duke synuar krijimin e tolerancës sociale si produkt përfundimtar të këtij projekti.

Marrëdhënia e Medias me Audiencat në Epokën Digjitale

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Kolegjin Universitar “Bedër” organizoi workshop-in me temë "Marrëdhënia e Medias me Audiencat në Epokën Digjitale". Për të diskutuar në panel morën pjesë Monika Stafa, Kryetare e Këshillit të Ankesave në AMA (Autoriteti i Mediave Audiovizive); Thanas Goga, ekspert i matjes së audiencave dhe profesor në Universitetin e Tiranës; Aleksandër Çipa, Kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë; Dr. Erlis Çela, përgjegjës i Departamentit të Shkencave të Komunikimit në Kolegjin Universitar “Bedër”; MSc. Edlira Mali, lektore pranë të njëjtit departament, si dhe Doc. Dr. Ramadan Çipuri, lektor në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës.

Gjatë workshop-it panelistët diskutuan në lidhje me audiencat në epokën dixhitale, ndërtimin e një tregu mediatik, etikën dhe deontologjinë e mediave në Shqipëri si dhe për sfidat e gazetarit përballë multimedialitetit në ditët e sotme.

Një theks i veçantë u vu në mungesën e statistikave të besueshme për matjen e audiencës si dhe nevojën e studimeve mediatike që do t'i vinin në ndihmë AMA-s për të ndërmarrë hapa konkretë në lidhje me rregullimin e tregut mediatik.

Projekt Studentor me efekt të gjerë kombëtar

Si pjesë e një projekti semestral në lëndën Komunikim Politik, në periudhën prill-qershor 2015, studentët e vitit të tretë “Bachelor” në Shkenca Komunikimi ndërmorrën projektin “Unë refuzoj të hesht. Bëje dhe ti, VOTO!” si një fushatë për ndërgjegjësimin e të rinjve që votonin për herë të parë që të merrnin pjesë në votime. Fushata konsistoi në aktivitete të ndryshme ku u përfshinë një numër i konsiderueshëm të rinjsh brenda dhe jashtë universitetit duke i dhënë kësaj fushate përmasa kombëtare.

Studentët organizatorë zhvilluan takime me të rinjtë duke diskutuar me ta domosdoshmërinë e të rinjve për tu bërë pjesë e vendimarrjes në qeverisje duke të kontribuar jo vetëm në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe qendrore, por edhe në të ardhmen e vendit.


Pjesë e këtij projekti ishte edhe konkursi për esenë më të mirë me temë “Unë refuzoj të hesht. Bëje dhe ti, VOTO!”, ku morrën pjesë të rinj nga universitetet dhe shkollat e mesme nga Tirana dhe rrethet e tjera të Shqipërisë, si Durrësi, Elbasani, Kavaja, etj.

Fushata u pasqyrua gjerësisht në mediumet e ndryshme, si në mediat tradicionale ashtu dhe në mediat e reja, duke i ftuar studentët të prezantojnë qëllimin, aktivitetet, sfidat dhe rezultatet e fushatës.

Gjatë periudhës akademike 2013-2018, janë zhvilluar aktivitete të shumta për të siguruar përfshirjen, aktivizimin dhe kreativitetin e studentëve. Tabela e mëposhtme tregon një pjesë të aktiviteteve të realizuara:

Tabela 19: Aktivitete të realizuara nga e me përfshirjen e studentëve gjatë periudhës akademike 2013-2018

Cikli - Studenti dhe Profesionit				
Data	I Ftuar	Profesionit	Institucioni	Tema e Trajtuar
12.10.2013	Ardian Bunguri	Drejtor PR	BKT	Bashkëbisedim me Studentët
09.10.2013	Arsen Hoxha	Gazetar		Media Publike vs Media Private
04.11.2014	Enton Abilekaj	Drejtor i Informacionit	News24	Gazetaria në TV sot
11.11.2014	Pandi Gjata	Kryeredaktor i lajmeve	Top Channel	Sfidat e profesionit të gazetarit
06.01.2015	Llazar Semini	Korrespondent	Associated Press në Shqipëri	Aktualiteti shqiptar në mediat botërore
16.01.2015	Ermal Çela	Drejtues	Telemetrix	Matja e audiencave
02.11.2015	Marin Mema	Gazetar	Top Channel	Gazetaria e Reportazheve
12.11.2015	Ornela Liperi	Kryeredaktore	Revista Monitor	Gazetaria Ekonomike
17.12.2015	Piotr Ufnal	Menaxher i shitjeve dhe Marketingut për Evropën qendrore dhe lindore	AFP - Agjenisa Franceze e Lajmeve	Steriotipizimi është veti e shoqërive të mbyllura
13.01.2016	Vjollca Meçe	Drejtoresha Ekzekutive	Komiteti Shqiptar i Helsinkit	Raporti i Gazetarit dhe Ligjin dhe Etikën
30.11.2016	Sonila Qazimi Osman Stafa Amela Shehu Xhevahir Qardaku	Gazetare dhe redaktore Redaktor në "Oktapod" Gazetare "Bypass Show" Gazetar	Vizion Plus ABC News TV	
31.01.2018	Desada Metaj	Gazetar Kryeredaktore	Emisioni Opinion Klan TV	Modeli i Talk Show politik në median shqiptare
06.06.2018	Eni Vasili	Gazetare	Emisioni Studio e hapur	Ekrani televiziv si pasqyrë e shoqërisë së sotme shqiptare
14.06.2018	Elert Yzeiri	Drejtor i Departamentit të Web-it	Top Channel	Sfidave të gazetarëve profesionistë në hapësirën dixhitale
Cikli - Seminare MarCom				
Data	I Ftuar	Profesionit	Institucioni	Tema e Trajtuar
13.11.2014	Suela Shtylla Ivica Spasovski	Administratore Drejtor Kreativ	McCann Tirana	Kreativiteti në procesin e prodhimit të reklamës
18.11.2014	Juela Isaj	Administratore	DDB Albania & Montenegro	Strukturën, Proceset dhe Funkcionimi i një agjencie reklamash
24.11.2014	Fisnik Ismaili	Drejtor Kreativ	Karrota	Ta jetosh marketingun
27.11.2014	Odetta Male George Spiliopoulos	Administratore Drejtor Kreativ	Landmark Communications	Ideimi, planifikimi dhe meaxhimi i fushatave publicitare
13.01.2015	Elda Gjoka	Themeluese dhe CEO	Genuine Effect	Të realizosh Efektin "Genuine"
22.04.2015	Auron Pasha	Themelues dhe Drejtor Ekzekutiv	Idra Research & Communication	Hulumtimet e tregut dhe opinionit - Procese dhe Aplikime
17.05.2015	Rafaela Rica	Themeluese dhe Administratore	Iceberg Communication	Nga Ideja në Traditë
27.11.2015	Arlinda Çausholli	Drejtoresha Komunikimi	Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës	Fit for the Future – rregullat e komunikimit për sukses në çdo fushë
10.05.2016	Ilda Lumani	Drejtoresha	Revista Bordo	Revistat përballë mediave online
09.06.2016	Gerti Boshnjaku	Drejtues dhe	New Media	Sfidat e Komunikimit



		Administrator	Communications	Marketing
17.11.2016	Klodian Makashi	Bashkëthemelues dhe CEO	Connext	Hashtagu
25.10.2017	Olti Curri	Blogger		Angazhimi i Audiencave në Marketingun Dixhital
10.04.2018	Edona Daçi	Themeluese dhe Manaxhere	Mundesi.al	Roli i teknologjisë në shpërndarjen e informacionit
24.10.2018	Eraldo Rexho	Themelues dhe Drejtor Editorial	RevistaWho.com	Gazetaria Rozë në Kohën e Internetit
Leksione të hapura & Workshope				
Data	I Ftuar	Profesioni	Institucioni	Tema e Trajtuar
06.11.2014	Erton Graceni	këshilltar për teknologjinë	Kryeministri	Një përvojë në Harvard
26.11.2014	Pandi Gjata	Kryeredaktor	Top Channel	Trajnim mbi artin e komunikimit
04.12.2014	Barbel Moser	Drejtoresh e Zhvillimit Ndërkombëtar	Radio France International	Bashkëbisedim rreth zhvillimeve të fundit në Evropë dhe rajon - Master I
16.01.2015	Edi Lesi	Kryeredaktor	Gazeta Standard Koha Jonë	Këshillimi në Marketing Politik
21.01.2016	Erald Kapri			PR politik dhe institucional
03.02.2016	Ema Andrea	Aktore		Arti dhe Komunikimi
19.04.2016	Milena Harito	Ministre	Ministria e Inovacionit dhe Administratës publike	Kuadri Ligjor për rregullimin e mediave online
03.05.2016	Behar Gjoka Alda Bardhyli Elvana Zaimi	Botues Botuese Gazetare	Revista "Pasqyra e t'rrëfyemit" Revista Saras Gazeta Fjala	Sfidat e shtypit periodik kulturologjik në Shqipëri
02.12.2016	Dr. Pandeli Pani	Profesor në disa universitete europiane	Projekti Risi Albania	Metodat efektive dhe atraktive të raportimit mbi tregun e punës në Shqipëri
05.12.2016	Karolina Risto Erida Gjermani	Drejtoresh e Informacionit Kryeredaktore	INTV	Trajnim mbi raportimet etike rreth çështjeve sociale
01.02.2017	Ramadan Çipuri			Promovim libri: Vetëcensura, realitete të gazetarisë shqiptare
12.05.2017	Dr.Arben Muka			Trajnim mbi gazetarinë në radio
15.11.2017	Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) Albanian Center for Public Communication			Të miturit në objektivin e medias
08.12.2017	Emirjon Senja	Kryeredaktor	Albeu.com	Trajnim mbi mediat online
23.05.2018	Galinija Gjoni	Eksperte për pronësinë intelektuale dhe zv. Presidente	Shoqata e Ekspertëve të Pronësisë Intelektuale	Pronësia intelektuale e markave dhe patentave
31.05.2018	Alma Janka Anxhela Ruçi Merxhan Daci	Kryeredaktore Gazetare Gazetar	Faktoje.al	Konvergenca e Medias Shqiptare, Etika dhe Besueshmëria
Panele Diskutimi & Workshope				
Data	Tema e Trajtuar			
03.05.2014	Gjuha mediatike e medieve shqipfolëse			
15.09.2014	Kurrikulat në përputhje me zhvillimet bashkëkohore			
29.01.2015	Europa dhe qytetaria aktive			
14.01.2016	Shoqëria e hapur, demokracia dhe edukimi si armë kundër ekstremizmit			
07.02.2017	Marrëdhënia e medias me audiencat në epokën digjitale			
16.05.2018	Fake News, problem i medias apo i demokracisë?			
06.02.2018	Jackques Derrida nën recensën tonë			
08.02.2018	Marrëdhënia e medias me audiencat në epokën dixhitale			
11.12.2018	"Ruaj traditën, festo shqip" me studiues dhe pedagogë rreth ruajtjes së folklorit			

Vizita në Institucione			
<i>Data</i>	<i>Përfaqësues</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Institucioni</i>
03.11.2017	Agron Hoxha	Drejtor i Radios dhe zyrës së Marrëdhënieve me Publikun	Radio Spektrum
23.12.2017	Ronald Zili	Kryeredaktori i Lajmeve	Vizion Plus
20.01.2018	Armela Krasniqi Almarina Gegvataj	Drejtoresh Kryeredaktore	ATSH
24.01.2018	Anduena Manushi	Drejtoresh Programacioni	News 24
08.03.2018			Burgu i Grave
15.05.2018	Shaip Kamberi	Kryetari i Komunës	Komuna Bujanoc, Serbi
Konkurse studentore			
<i>Data</i>	<i>Tema e Trajtuar</i>		
28.02.2017	Universiteti në objektivin tim		
26.05.2015	Unë refuzoj të hesht. Bëje dhe ti, VOTO		
Cikli - Lexime nën Hënën e Plotë			
<i>Data</i>	<i>I Ftuar</i>	<i>Vepra - Tema e Trajtuar</i>	
19.11.2014	Luljeta Lleshanaku	Bashkëbisedim	
05.11.2015	Besnik Mustafaj	Bashkëbisedim	
29.01.2016	Uran Butka	Lufta civile e viteve 1943 – 1945	
27.10.2016	Elona Agolli	“Prit edhe Pak” nga Dritëro Agolli	
25.01.2017		Mbrëmje poetike kushtuar veprës së Gjergj Fishtës	
06.12.2018	Elona Zeraliu	Mbrëmje folklorike në rrënjët e traditës shqiptare	

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit,

Tabela 20: Ngarkesa totale në auditor për format e mësimdhënies

Programi i Studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1,568
Seminare	272
Ushtrime	
Laboratore	
Praktikë lëndore	48
Praktikë profesionale	
Provim Përfundimtar	72
Në total	1960

- Format e kontrollit të njohurive

Tabela 21: Shembull për format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	P.sh. 10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%
Testimet gjatë vitit	30%
Provim përfundimtar	40%
Projekte	10%
Në total	100%

Shënim: Të dhënat e mësipërme mund të gjenden në pjesën e fundit të syllabuseve të çdo lënde, duke qenë se çdo lektor përcakton format e tij të kontrollit të cilat ju bëhen të qarta studentëve në fillim të semestrit përkatës.

Tabela 22: Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	7
Për projekte shkencore në rang Departamenti	26
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	32
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	17



STUDENTËT

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga KUB, deri në vitin 2015 janë bërë sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 80/2015 “për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, procedurat për pranimin e studentëve të ciklit të parë janë ndryshuar në përputhje me të.

Për pritjen dhe shpjegimin e ofertës akademike, KUB ka ngritur zyrën e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve. Me qëllim realizimin e një procesi mësimor sa më rezultativ, KUB i kushton një rëndësi të veçantë raportit numerik personel akademik/student, i cili siguron edukimin cilësor dhe objektivat e institucionit. Raporti në fjalë, në nivel institucional, është 1 (një) personel akademik për 8.03 studentë në shkallë institucionale.

Kohëzgjatja normale e përfundimit të studimeve bachelor është gjashtë semestra. Periudha maksimale e studimeve është dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve.


Me qëllim për të garantuar një komunikim sa më të shpejtë midis institucionit dhe studentit, KUB ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Përveç kësaj, sekretaria mësimore, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura, bën njoftime edhe me anë të postës elektronike në adresat personale që kanë studentët të ofruara nga zyra e IT në KUB. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar. Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KUB përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit të jashtëm. Në këtë funksion, pranë KUB shërben edhe zyra e protokollit dhe korrespondencës.

Studentët e regjistruar në KUB informohen në kohë reale përmes sistemit BIS, ku në ekranin e gjithsecilit shfaqet njoftimi përkatës. Komunikimi i brendshëm në KUB kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: Shkronja e parë e emrit, mbiemri@beder.edu.al.

Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, që në momentin e regjistrimit, KUB plotëson dosjen personale të çdo studenti konform rregullave ligjore. Dosjet në fjalë mbahen në zyrën e sekretarisë mësimore.

Një hap pozitiv është bërë përsa i përket pjesëmarrjes së studentëve si të ftuar në mbledhjet e njësive bazë dhe kryesore. Po ashtu në Senat Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë, si dhe në komisionet e përhershme ata janë anëtarë me të drejta të plota.

Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KUB ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë dekanatit të studentëve. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësitë e punësimit për të gjithë studentët e diplomuar në programet “Bachelor” dhe “Master i shkencave”, organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj.



Programet e studimeve në KUB janë hartuar duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në Deklaratën e Bolonjës, në mënyrë që të mundësojnë përshtatjen progresive të studentit me programin e studimit. Raporti I lëndëve në formimin e përgjithshëm profesional, teknik etj. janë të përcaktuara sipas këtyre standardeve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara nga MAS.

Në mënyrë periodike, KUB informon studentët në lidhje me çdo zhvillim të rëndësishëm institucional. Metodatat e informimit janë të ndryshme, si me anë të faqes së internetit, ashtu edhe me vënien në dispozicion të studentëve të materialeve ose broshurave informuese. Këto të fundit mund t'u jepen në dorë ose mund të lihen në ambientet e përbashkëta, ku studentët kanë mundësi t'i përdorin.

Në KUB, nëpërmjet strukturave të këshilltarëve akademikë dhe këshilltarëve të karrierës, studentët mbështeten për zgjidhjen e nevojave të tyre në të gjitha ciklet e studimeve. Organizimi dhe mbështetja që u bëhet klubeve studentore në çdo aspekt, si dhe në atë akademik dhe financiar, është një tregues i rëndësishëm i politikës mbështetëse për studentët.

Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit. Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KUB mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, përmes lejeve të siguruar prej tyre, viziton shkollat e mesme në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KUB.

KUB është një institucion që ka kritere në pranimin e studentëve. Varësisht politikave institucionale si një institucion jofitimprurës, KUB ka pranuar një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe të burimeve njerëzore që zotëron. Përmes kësaj politike, KUB ka synuar angazhimin maksimal të personelit akademik ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim. Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panairëve etj. KUB bën publike ofertën vjetore të programeve që ofron.


Në kuadër të këshillimit të karrierës, përkrah aktiviteteve të mësipërme, KUB organizon edhe ditët e hapura, apo edhe ditët e orientimit për studentët e rinj.

Në kuadër të zyrës së dekanit të studentëve është hapur zyra e të diplomuarve, si dhe zyra e planifikimit të karrierës, përgjegjësitë e së cilës parashikohen në rregulloren e organizimit administrativ, pjesa që përshkruan funksionet e dekanit të studentëve. KUB, nëpërmjet praktikave profesionale gjatë të gjithë vitit dhe marrëveshjeve të nënshkruara me kompani të ndryshme, mundëson një tranzicion të lehtë në punësim. Nëpërmjet zyrës së planifikimit të karrierës, personeli akademik, ai ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës së punësimit të studentëve. Në politikatat e KUB parashikohen politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve të vet. Aktualisht nga departamenti i shkencave të komunikimit janë punësuar 4 të diplomuar pranë institucionit, si dhe 91% e të diplomuarve janë punësuar dhe/ose ndjekin një cikël tjetër studimesh. Institucioni nëpërmjet këtyre zyrave ka statistika të sakta në lidhje me të diplomuarit e saj.

Kushte specifike të pranimit të studentëve

Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, për vitin akademik 2018-2019, janë si më poshtë:

1. Mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70%.
2. Intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%.



Plotësimi i kushtit të mjaftueshmërisë së gjuhës së studimit, për programet “Master profesional” dhe programet e ciklit të dytë që ofrohen në gjuhë të huaj, e cila nuk është e përfshirë në udhëzimin nr.52, datë 3.12.2015

Programi përcakton dhe ndjek afatet e aplikimit dhe regjistrimit në përputhshmëri të plotë me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për Arsimin ndërvite si më posht:

1. Udhëzim nr.14, datë 9.7.2013 “Për procedurën e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga IAL privat, si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2013-2014”, i ndryshuar
 - Udhëzim nr.19, datë 30.7.2013 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 14, datë 9.7. 2013 “Për procedurën e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga IAL privat, si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2013-2014”
 - Udhëzim nr.59, datë 2.12.2013 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.7. 2013“Për procedurën e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga IAL privat, si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2013-2014”
 - Udhëzimi nr.5, datë 11.3.2014 “Për një ndryshim në udhëzimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 9.7.2013“Për procedurën e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga IAL privat, si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2013-2014”, i ndryshuar
2. Udhëzim nr.43, date 15.10.2014 “Per proceduren e pranimit dhe te regjistrimit ne programet e studimit te ciklit te pare dhe te dyte, te ofruara nga institucionet private te arsimit te larte, si dhe per transferimin e studimeve ne programet e studimit, te ofruara nga keto institucione, per vitin akademik 2014-2015”, i ndryshuar
 - Udhëzim nr.54, date 3.11.2014 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.43, date 15.10.2014 “Per proceduren e pranimit dhe te regjistrimit ne programet e studimit te ciklit te pare dhe te dyte, te ofruara nga institucionet private te arsimit te larte, si dhe per transferimin e studimeve ne programet e studimit, te ofruara nga keto institucione, per vitin akademik 2014-2015”
 - Udhëzim nr. 58, date 5.12.2014 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.43, date 15.10.2014 “Per proceduren e pranimit dhe te regjistrimit ne programet e studimit te ciklit te pare dhe te dyte, te ofruara nga institucionet private te arsimit te larte, si dhe per transferimin e studimeve ne programet e studimit, te ofruara nga keto institucione, per vitin akademik 2014-2015”
3. Udhëzimi nr.37, date 5.10.2015 “Për proceduren e pranimit dhe te regjistrimit ne programet e studimit te ciklit te pare dhe te dyte, te ofruara nga institucionet private te arsimit te larte, si dhe per transferimin e studimeve ne programet e studimit, te ofruara nga keto institucione, per vitin akademik 2015-2016”, i ndryshuar
 - Udhëzimi nr.53, datë 16.12.2015 “Për disa ndryshime në udhëzimi nr. 37, date 5.10.2015 “Për proceduren e pranimit dhe te regjistrimit ne programet e studimit te ciklit te pare dhe te dyte, te ofruara nga institucionet private te arsimit te larte, si dhe per transferimin e studimeve ne programet e studimit, te ofruara nga keto institucione, per vitin akademik 2015-2016”,
4. Udhëzimi nr.13, datë 22.7.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programe të studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017, i ndryshuar
 - Udhëzimin nr.15, datë 1.8.2016 “Për disa shtesa në udhëzimi nr.13, datë 22.7.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programe të studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017”
 - Udhëzimi nr.22, datë 6.9.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.13, datë 22.7.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programe të studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017”



- Udhëzimin nr.24, datë 7.10.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimi nr.13, datë 22.7.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programete studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017, i ndryshuar
 - Udhëzimin nr.25, datë 27.10.2016 “Për një ndryshim në udhëzimi nr.13, datë 22.7.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programete studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017
5. Udhëzimi nr.15, datë 19.5.2017 “ Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programete studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”, i ndryshuar me:
- Udhëzimin nr.18, datë 16.8.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimi nr.15, datë 19.5.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programete studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”
 - Udhëzimin nr.23, datë 16.10.2017 “Për disa ndryshime në udhëzimi nr.15, datë 19.5.2017 “Për procedurat e pranimit dhe te regjistrimit ne vitin akademik 2017-2018”, i ndryshuar
6. Udhëzimi nr.18, datë 21.5.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programete studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019”, i ndryshuar me:
- Udhëzimi nr 26, datë 30.7.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimi nr.18, datë 21.5.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit ne programet e ciklit te pare të studimeve, në programete studimit me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019”
- Udhëzimi nr.33, datë 23.10.2018 “ Për një shtesë në udhëzimi nr.18, datë 21.5.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe te regjistrimit në vitin akademik 2018-2019”, i ndryshuar

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Tabela 23: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Sipas Viteve	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Nota mesatare ne hyrje	Studentë të transferuar sipas viteve (b)						Totali i Studentëve të transferuar (b)	Totali (a)+(b)
			Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti VI		
2013-2014	23	7.94	0	0	0	0	0	0	0	23
2014-2015	45	7.85	0	0	0	0	0	0	0	45
2015-2016	28	7.53	0	0	0	0	0	0	0	28
2016-2017	28	7.96	0	0	0	0	0	0	0	28
2017-2018	23	7.70	0	1	1	0	0	0	2	25
2018-2019	22	7.71	0	0	0	0	0	0	0	22

[Signature]

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

KUB lejon transferimin e studentëve në vitet ndërmjetës nga IAL-të vendase ose të huaja, publike ose private, dhe anasjellas, si edhe brenda programeve të studimeve që ai ofron. Ky proces bëhet pas një barasvlerësimi sipas planeve mësimore përkatës. Transferimi lejohet ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh.

KUB ofron mundësi për transferime të studimeve midis programeve të të gjitha cikleve brenda KUB apo nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin.

Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë:

- Njeshmëria e programit të studimit
- Koha e kryerjes së studimeve

Një komision adhoc me tre anëtarë që ngrihet nga Këshilli i Departamentit vendos për transferimet që kryhen në programet e KUB. Ky këshill kryen të gjitha procedurat përkatëse të ekuivalentimit të lëndëve për programet e ciklit të parë, duke i shoqëruar me një argumentim mbi kushtet e pranimit. Në përputhje me këtë, studentët të cilët kanë kryer procedurat e ekuivalentimit, pajisen me diplomë vetëm në rast se kanë ndjekur jo më pak se dy semestra studime pranë KUB.

Mënyra e transferimit në programet e ofruara në KUB parashikohet në Rregulloret mësimore të KUB.⁵⁴

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Tabela 24: Të dhëna për punësimin e studentëve

Periudha e të dhënave (psh. 2013-2018)			
Programi i studimit "Bachelor" në Shkenca Komunikimi	Numri total të diplomuarëve	Numri total i të punësuarëve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarëve (jo në përputhje me diplomën)
	117	64	33

Vlerësimi sipas Standardeve


Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1. Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Kriteri 1: Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga KUB deri në vitin 2015 janë bërë sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 80/2015 "për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", procedurat për pranimin e studentëve të ciklit të parë janë ndryshuar në përputhje me të.
Kriteri 2. Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për	Kriteri 2: Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, për vitin akademik 2018-2019, si më

⁵⁴ Evidenca nr. 57: Rregullorja "Për transferimin e studimeve"

<p>përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70%. 2. Intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%. <p>KUB ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. KUB ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p>	<p>Kriteri 1: Studentët e KUB informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit që ndjekin, mënyrën e organizimit dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet javës së orientimit⁵⁵ në fillim të vitit akademik, guidës së studentit, si edhe informacionit të publikuar në faqen zyrtare të IAL-së.</p> <p>Me qëllim për të garantuar një komunikim sa më të shpejtë midis institucionit dhe studentit, KUB ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Përveç kësaj, sekretaria mësimore, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura, bën njoftime edhe me anë të postës elektronike në adresat personale që kanë studentët të ofruara nga zyra e IT në KUB.</p> <p>Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë emaili institucionale të gjithë studentët e regjistruar.</p> <p>Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KUB përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit të jashtëm. Në këtë funksion, pranë KUB shërben edhe zyra e protokollit dhe korrespondencës.</p> <p>Studentët e regjistruar në KUB informohen në kohë reale përmes sistemit BIS, ku në ekranin e gjithsecilit shfaqet njoftimi përkatës.</p> <p>Komunikimi i brendshëm në KUB kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: Shkronja e parë e emrit, mbiemri@beder.edu.al.</p> <p>Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, që në momentin e regjistrimit, KUB plotëson dosjen personale të çdo studenti konform rregullave ligjore. Dosjet në fjalë mbahen në zyrën e sekretarisë mësimore.⁵⁶ Një hap pozitiv është bërë përsa i përket pjesëmarrjes së studentëve si të ftuar në</p>

⁵⁵ Evidenca nr. 35: Programi i ditëve të orientimit


⁵⁶ Evidenca nr. 48: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore



<p>Kriteri 2. Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4. Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>mbledhjet e këshillit të departamentit.</p> <p>Po ashtu në Senatit Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë, si dhe në komisionet e përhershme ata janë anëtarë me të drejta të plota.⁵⁷</p> <p>Kriteri 2: KUB ka një rregullore të posaçme për vlerësimin e personelit në çdo fund semestri dhe viti akademik. Procedura dhe mënyra e vlerësimit organizohet sipas rregullores mbi anketat dhe vlerësimet, e cila përfshin vlerësimet e studentëve për personelin, vetëvlerësimin e personelit, vlerësimin e eprorëve për vartësit etj. Anketimet e studentëve për personelin akademik plotësohen përmes Sistemit online të informimit (Beder Information System - BIS), para zhvillimit të provimeve finale në çdo fund semestri. Plotësimi i pyetësorëve është anonim dhe përgjigjet përpunohen në mënyrë automatike dhe të pavarur.</p> <p>Pas sigurimit të të dhënave vlerësuese për personelin akademik, në fund të çdo semestri akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të personelit akademik, rezultati i të cilit dorëzohet nëpërmjet një zarfi të mbyllur.</p> <p>Kriteri 3: Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KUB ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentin. Pranë kësaj zyre, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës⁵⁸, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar.</p> <p>Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësi punësimi për të gjithë studentët e diplomuar në programet “Bachelor” dhe “Master”, organizon aktivitete që synojnë ruatjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj.</p> <p>Një rol i rëndësishëm i kësaj zyre është mundësimi i praktikave profesionale për studentët e të gjithë departamenteve që ofron KUB.</p> <p>Kriteri 4: Nëpërmjet këshillimit të karrierës, leksioneve të hapura, të ftuarve të ndryshëm, seminareve profesionale etj., studentët e KUB informohen hollësisht për mundësitë e punësimit pas diplomimit në këtë program studimi.</p> <p>Në Departamentin e Shkencave të Komunikimit ka pasur një gamë të gjerë leksionesh të hapura të titulluara si “Studenti dhe profesioni”, “Seminaret MarCOM” etj., përmes të cilave studentët janë informuar mbi mundësitë e punësimit në tregun e punës.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	

⁵⁷ Evidenca nr. 51: Vendim i Senatit për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale

⁵⁸ Evidenca nr. 53: Shkresë për emërimin e këshilltarit për Këshillimin e Karrierës



<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Kriteri 1: KUB, në strukturën organizative ka ngritur Zyrën e të Diplomuarëve, e cila funksionon në varësi të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët. Kjo zyrë mban të dhëna në lidhje me të diplomuarit, punësimin e tyre, etj. Nga ana tjetër, Zyra e Sekretarisë Mësimore, ndër funksionet e saj ka edhe përpunimin e të dhënave në formë statistikore të të diplomuarëve. Kjo parashikohet në rregulloren e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, neni 3 i saj.⁵⁹</p> <p>Kriteri 2: Zyra e Sekretarisë Mësimore pranë KUB ndjek nga afër regjistrimin e të gjithë studentëve duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre dhe raporton në mënyrë periodike në fund të çdo semestri statistikat e studentëve të çdo programi.</p> <p>Kriteri 3: Të gjitha rezultatet e vlerësimit të studentëve në çdo lëndë nëpërmjet sekretarisë së departamentit i kalojnë Zyrës së sekretarisë mësimore, e cila i arkivon ato. Ndërkohë, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentin është ngritur edhe zyra për planifikimin e karrierës, e cila është e angazhuar në ndjekjen e mundësive për praktika profesionale të studentëve. Kjo zyrë i ndjek ata deri në çastin e diplomimit.</p>
--	---


Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1. Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p>	<p>Kriteri 1: Në kuadër të planifikimit të karrierës, krahas zyrës së Planifikimit të Karrierës, KUB, pranë çdo departamenti ka ngritur Bordin e Këshillimit të Karrierës, në përbërje të të cilit janë shtatë anëtarë profesionistë, aktivë në profesionin e tyre. Ky bord u mundëson studentëve lidhjet e tyre me tregun e punës.⁶⁰</p> <p>Zyra për planifikim e karrierës ndjek nga afër edhe procesin e praktikave profesionale të studentëve të cilëve u ka mundësuar një praktikë të tillë.</p> <p>Gjithashtu, e përmendur edhe më sipër, në nivel departamenti ka pasur një sërë aktivitetesh të cilat u vijnë në ndihmë studentëve për të krijuar sa më shumë lidhje me tregun. Përmendim këtu serinë e leksioneve të hapura “Studenti dhe profesioni”, “Seminaret MarCOM”, etj.</p> <p>Nga ana tjetër, çdo grup studentësh ka një këshilltar akademik, të përcaktuar nga njësia bazë në çdo fillim viti akademik.</p> <p>Këshilltari ndjek dhe udhëzon studentin mbi anën akademike, gjatë periudhës studimore. Këshilltari miraton formularët e regjistrimit semestral për çdo student përkatës. Detyrat e këshilltarit Akademik janë të parashikuara në Rregulloren mbi Organizimin Akademik.⁶¹</p> <p>Këshilltarit akademik i sigurohet një akses i posaçëm në llogarinë e</p>
---	---

⁵⁹ Evidenca nr. 48: Rregullore e Zyrës së Sekretarisë Mësimore

⁶⁰ Evidenca nr. 54: Shkresë për krijimin e Bordit për Këshillimin e Karrierës

⁶¹ Evidenca nr. 6: Rregullore mbi Organizimin Akademik



Kriteri 2. Institucioni (nëpërmjet Zyrës për Këshillimin e Karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

tij në BIS, për një komunikim më të detajuar me studentët që ka nën përkujdesje.

Kriteri 2: Në ndihmë të studentëve departamenti i Shkencave të Komunikimit, në mënyrë të bashkërenduar me Zyrën për Planifikimin e Karrierës, ka krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Departamenti dhe zyra në fjalë i ka ndihmuar studentët në përzgjedhjen e institucionit, në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, duke dërguar kërkesa të veçanta për çdo institucion brenda dhe jashtë vendit.⁶²

Praktika profesionale është një lëndë e veçantë në programin mësimor në ciklin e parë “Bachelor” në Shkenca Komunikimi. Megjithatë, studentëve të këtij profili, u jepet mundësia për realizim praktike profesionale edhe përtej kërkesave të kësaj lënde.

Çdo vit, studentët e interesuar për praktikë profesionale paraqesin kërkesën për realizimin e tyre.

Pas paraqitjes së kërkesave nga studentët e interesuar, departamenti në kordinim me Zyrën e Planifikimi të Karrierës, nëpërmjet rrjetit të gjerë të kontakteve dhe marrëveshjeve me institucione, organizata e biznese të ndryshme, mundohet të sigurojë përfshirjen e studentëve në realizimin e praktikave profesionale dhe internshipeve në këto institucione partnere në përputhje me interesin e tyre. Marrëveshjet me këto institucione janë të tilla, që gjatë praktikave mësimore, në përputhje me nevojat e vetë institucioneve për personel dhe performancës së studentëve, të shikohet mundësia e punësimit të studentëve pranë tyre pas përfundimit të studimeve.

Konkluzionet e GVB

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për fushën e vlerësimit “Studentët dhe mbështetja e tyre” konstaton se standardet janë **përbushur plotësisht**. Institucioni dëshmon se ndjek politika ndihmëse në pranimin e studentëve që plotësohen me angazhimin maksimal të personelit ndaj studentit. Për këtë arsye, KUB pranon një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe të burimeve njerëzore. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për studentët dhe siguron një komunikim të shpejtë dhe efektiv ndërmjet institucionit dhe studentit, përmes veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë, si dhe sekretarisë mësimore, përfaqësimit të tyre në organet vendimmarrëse të IAL-së etj.

Institucioni siguron informacion në kohë reale përmes sistemit BIS, si dhe nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. KUB ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. KUB ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj.

Departamenti, në koordinim me Zyrën e Planifikimi të Karrierës, nëpërmjet rrjetit të gjerë të kontakteve dhe marrëveshjeve me institucione, organizata e biznese të ndryshme, siguron përfshirjen e studentëve në realizimin e praktikave profesionale në përputhje me interesin e tyre.

⁶² Evidenca nr. 55: Shkresë kërkesë institucioneve për praktikë profesionale të studentëve

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kërkimi shkencor në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien, vlerësime zyrtare të aktivitetit kërkimor individual ose për njësinë.

Politikat e kërkimit shkencor

Kolegji Universitar “Bedër” është një Institucion i Arsimit të Lartë, i orientuar drejt kërkimit shkencor. Institucioni inkurajon të gjithë anëtarët e personelit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ndjekur një politikë stimuluese për nxitjen e aktivitetit kërkimor të personelit akademik. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka patur një angazhim cilësor dhe produktivitet në publikimet e personelit dhe angazhimin në kërkimin shkencor

Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka qenë organizator dhe bashkë-organizator në 3 konferenca shkencore ndërkombëtare. Personeli akademik i departamentit ka qenë pjesëmarrës në këto konferenca duke paraqitur punimet e tyre shkencore. Departamenti i kërkon secilit nga pjesëtarët e personelit akademik efektiv, të dorëzojë planin vjetor për kërkimin shkencor dhe publikimet. Në çdo fund viti, si pjesë e raportit vjetor të departamentit, publikohet lista e publikimeve të personelit akademik në konferenca dhe revista shkencore.

Informacion për ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Për të realizuar lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, i është kushtuar një rëndësi të veçantë përfshirjes në syllabus si zë i vlerësimit të studentëve, përgatitja e eseve kërkimore dhe detyrave të kursit që i ndihmojnë studentët në marrjen e njohurive të nvojshme për kërkimin shkencor.

Po kështu edhe organizimi i konferencave studentore dhe nxitja e studentëve në pjesëmarrjen dhe prezantimin e punëve të tyre kërkimore, shënon një kontribut të rëndësishëm në rritjen e nivelit të përfshirjes së tyre në kërkim shkencor. Konferencat studentore të organizuara nga departamenti janë parë edhe si një mundësi për të ndihmuar studentët në kuadër të përgatitjes së punimit të diplomës.


Në kuadër të vlerësimit të aktivitetit kërkimor, është ngritur Zyra e Kërkimit Shkencor e cila luan rol të rëndësishëm si njësi koordinuese dhe ndihmuese për departamentet dhe personelin akademik. Zyra ndihmon në trajnimin e personelit akademik, mbi teknikat e reja të shkrimit të projekteve kërkimore si dhe informon njësitë departamentet për mundësitë e reja që ofrohen nga qendra brenda dhe jashtë vendit në kuadër të kërkimit shkencor.

KUB inkurajon të gjithë anëtarët e personelit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare bazuar në Udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor.⁶³

KUB ofron gjithashtu, mbështetje financiare për pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit⁶⁴. Çdo anëtar i personelit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari. Në të njëjtën kohë, organizimi ose bashkëorganizimi i konferencave dhe i veprimtarive shkencore të një niveli ndërkombëtar është një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës kërkimore të KUB. Nga ana tjetër, Institucioni ka në përbërjen e strukturës së tij edhe Zyrën e Kërkimit Shkencor, e cila luan një rol të rëndësishëm në fushën e kërkimit dhe projekteve shkencore.

⁶³ Evidenca nr. 60: Udhëzim mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor

⁶⁴ Evidenca nr. 63: Praktikë e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca



Konferenca dhe workshope

12 Mars 2014 - Konferenca II Studentore: “Komunikimi, media dhe përgjegjësia sociale”

Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar “Bedër” organizoi konferencën e dytë studentore me temë: “Komunikimi, media dhe përgjegjësia sociale”. Në këtë konferencë u prezantuan 18 punime shkencore nga studentët e vitit të tretë të nivelit bachelor. Konferenca u hap me fjalën përshëndetëse të zv-përgjegjësit të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, njëkohësisht edhe kryetari i kësaj konference, dokt. Ramadan Çipuri, i cili falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe studentët për punimet e realizuara. Gjatë fjalës së tij, ai vuri në pah rëndësinë që paraqet kërkimi shkencor i vetë studentëve të shkencave të komunikimit, krahas formimit teorik që ata marrin në auditor, si dhe praktikave profesionale që zhvillojnë nëpër media të ndryshme.

27 Mars 2014 - Kultura dhe arsimit si ura komunikimi midis Shqipërisë dhe Francës

Kolegji Universitar “Bedër”, në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Francës në Tiranë, me rastin e Javës së Frankofonisë, organizoi panelin me temë “Kultura dhe arsimit si ura komunikimi midis Shqipërisë dhe Francës”.

Paneli ishte konceptuar si një tryezë e rrumbullakët, ku të ftuar që vinin nga fusha akademike, media, kultura dhe arti, ndanë idetë e tyre dhe diskutuan në lidhje me rolin që ka kultura dhe arsimit në forcimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Francës.

Rektori i KUB, Dr. Ferdinand Gjana, pasi u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve në panel, u ndal në rëndësinë e shkëmbimit të vlerave mes kulturave, duke theksuar se qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti është një përpjekje për të dhënë një kontribut në këtë drejtim.

Ambasadorja e Francës në Tiranë, znj. Christine Moro u shpreh e kënaqur me organizimin e këtij aktiviteti dhe vuri në dukje dëshirën e ambasadës për të bashkëpunuar me universitetin në organizimin e aktiviteteve të ngjashme. Ajo bëri një përshkrim historik të marrëdhënieve Shqipëri- Francë, duke u ndalur në rolin e madh që ka lojtur Liceu Francez i Korçës (Liceu Kombëtar). Ndërkohë, që nënvizoi faktin se shkëmbimet kulturore mes dy vendeve, ndonëse kanë një histori të gjatë, vitet e fundit janë intensifikuar duke përmendur dhe emra të mëdhenj të letërsisë dhe artit shqiptar, që përfaqësojnë kulturën shqiptare në Francë, si Ismail Kadare, Fatos Kongoli, Inva Mula etj.

Më tej në diskutime morrën pjesë Ministrja e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro, znj. Mimoza Hafizi, deputete e Partisë Socialiste dhe njëkohësisht kryetare e grupit të miqësisë Shqipëri- Francë në Kuvendin e Shqipërisë. Panelistët e tjerë, si Prof. Dr. Petrit Malaj, Prof. Dr. Shezai Rrokaj, Prof. Dr. Mark Marku dhe z. Aleksandër Çipa, ndanë pikëpamjet e tyre, në lidhje me temën duke hedhur dhe propozime konkrete në funksion të forcimit të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Francës.

Në fund të diskutimeve panelistët dhe të ftuarit e shumtë që ishin të pranishëm, morën pjesë në çeljen e ekspozitës fotografike “Realitete shqiptare në objektivin e AFP-së”, punime këto të fotoreporterit Genti Shkullaku. Ekspozita përmbante 30 fotografi nga realiteti shqiptar në 3-4 vitet e fundit.

3 Maj 2014 - Workshop Rajonal me temë “Gjuha mediatike e medieve shqipfolëse”

Në kuadër të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar “Bedër” në bashkëpunim me Unionin e Gazetarëve Shqiptarë, organizoi sot Workshopin rajonal me temë “Gjuha mediatike e medieve shqipfolëse”.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm rreth 40 përfaqësues mediesh në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Kryesisht të medieve vizive, shtypit të shkruar dhe atij online, si dhe një numër i konsiderueshëm studentësh të shkencave të komunikimit.

Si folës kryesor në këtë panel ishin analistët e njohur Kim Mehmeti dhe Lutfi Dervishi. Por duhet theksuar se përgjatë gjithë këtij aktiviteti të gjithë të pranishmit ndanë mendime, përvoja profesionale si dhe referuan në një sërë drejtimesh rreth temës së workshopit.

Fillimisht të pranishmëve u foli drejtuesi i këtij paneli dhe njëkohësisht përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar “Bedër” Z. Ramadan Çipuri, i cili pasi u uroi mirëseardhjen të pranishmëve shtroi për diskutim temën e workshopit dhe bëri një përmbledhje të shkurtër rreth rëndësisë dhe aktualitetit të medias në trevat shqipfolëse.

Vazhdoi më tej me gazetari Aleksandër Çipa, Kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë. Ky i fundit e vuri theksin mbi gjetjen e një gjuhe të përbashkët nga mediet shqipfolëse dhe bashkëpunimin mbi përmirësimin e kushteve në të cilat bëhet gazetaria sot në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Aktiviteti vazhdoi deri në fund të tij me diskutime të shumta nga të pranishmit rreth temës së workshopit.

26-27 Mars 2015 – ICCMS 2015

Konferenca Ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim me temë: “Industria e medias, trendet, dinamika dhe sfidat”, u organizua nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar “Bedër”, në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, “Ipek University” në Ankara, Universitetin e Prishtinës dhe Unionin e Gazetarëve Shqiptarë. I ftuar si folësi kryesor ishte Prof. Eric Scherer nga Franca, njëkohësisht edhe drejtor i “Future Media” në Televizionin Publik Francez.

14 Maj 2015- Konferenca e tretë studentore në komunikim

Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar “Bedër” zhvilloi për të tretin vit radhazi konferencën studentore me temë: “Media dhe komunikimi masiv në epokën digjitale”, ku studentët e vitit të 3-të të programit bachelor prezantuan para të pranishmëve punimet individuale. Punimet e konferencës u përshëndetën nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane Dr Ayhan Tekinesh.


26 Maj 2015 - “Domosdoshmëria e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje”

Studentët e vitit të 3-të të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, në kuadër të fushatës së sensibilizimit të të rinjve për të votuar, organizuan konferencën studentore me temë “Domosdoshmëria e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje”. Aktiviteti vazhdoi me prezantimin e punimeve të përgatitura nga vetë studentët si dhe maturantë të gjimnazeve të Tiranës, të cilët ndanë me të pranishmit pikëpamjet e tyre rreth procesit të të votuarit dhe rëndësisë që ka ky hap në vendimmarrje.

15 Dhjetor 2016 - Konferencë Ndërkombëtare në Studimet e Medias dhe Komunikimit

Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar “Bedër”, në bashkëpunim me Autoritetin e Medieve Audiovizive, Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës dhe Kolegjin AAB në Prishtinë, organizuan edicionin e dytë të Konferencës Ndërkombëtare në Studimet e Medias dhe Komunikimit me temë: “Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre”. Gjatë ceremonisë së hapjes ishin të pranishëm personalitete të ndryshëm nga fusha akademike, përfaqësues të medias dhe gazetarë të shumtë, studiues, rektorë universitetesh, përfaqësues të institucioneve publike e private prej të cilëve mund të përmendim z. Gentian Sala- kryetar i Autoritetit të Medieve Audiovizive; Prof. asoc. dr. Mark Marku-përgjegjës i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës; Dr. Hasan Saliu-zëvendësrektor për kërkimin shkencor në Kolegjin Universitar AAB; deputeti Genc Pollo-kryetar i komisionit parlamentar për edukimin dhe mjetet e informimit publik si dhe një numër i konsiderueshëm studentësh të gazetarisë dhe komunikimit.

Punimet e konferencës vazhduan më tej në sesione të ndryshme me referimin e dhjetëra studiuesve të ardhur nga Maqedonia, Kosova, rajoni e më gjerë. Ndër temat e shumta që u trajtuan dhe u sollën në vëmendje përmendim: “Informaliteti në mediet lokale dhe pafuqia rregulluese e autoritetit ligjzbatues”, “Mediat lokale dhe ndikimi i tyre mbi angazhimin qytetar përmes medias sociale”, “Tranzicioni i medieve lokale në Kosovë”, “Maqedonia dhe sfidat e shumëfishta të një tregu mediatik dy-gjuhësor.” etj.



13 qershor 2018 - Konferenca e Katërt Studentore në Shkenca Komunikimi

Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë KUB zhvilloi për të katërtin vit radhazi konferencën studentore me temë: “Komunikimi në Epokën Digjitale: Gazetaria, Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimi Politik.” Në konferencë morën pjesë studentë nga Kolegji Universitar “Bedër” dhe Universiteti i Tiranës, të cilët paraqitën punimet e tyre. Konferenca mundësoi një platformë diskutimi rreth ndikimit të medias digjitale në formësimin e politikës, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave, studentët kishin mundësinë që të njihen me zhvillimet më të fundit në këtë fushë, me sfidat dhe përparësitë që ka ndikimi i mediave digjitale në procesin e komunikimit.

Ndër temat që u trajtuan në sesionet përbërëse të konferencës përmendim: *Sa ndikojnë mediet sociale në emisionet televizive?; Raporti midis skriptualitetit dhe vizualitetit në median online; Titulli në raport me përmbajtjen e lajmit në portalet online; Etika e imazhit në edicionet informative; Misioni dhe problematika e gazetarisë investigative në Shqipëri; Rëndësia e marrëdhënieve me publikun në organizatat shqiptare; Problematikat e portaleve informative si pjesë e medias online në Shqipëri; Sfidat dhe përparësitë e komunikimit politik në median online; Ndikimi i raportimeve sportive në ndjenjën e patriotizmit; Menaxhimi i burimeve të informacionit në gazetarinë politike; Teknikat dhe metodat për përmirësimin e kanaleve të komunikimit në administratën publike; si dhe shumë tema të tjera aktuale, që prekin aspekte të ndryshme të medias dhe komunikimit në epokën e teknologjisë moderne.*

Në fund të Konferencës Studentore u shpërndanë certifikata për pjesëmarrësit, si dhe iu dha çmimi për punimin më të mirë studentit Alban Tufa, për punimin: “Propaganda e përçarur përmes poezisë në revistat (“Bota e re”, “Literatura jonë”, “Letërsia jonë” dhe “Nëndori”) organe të ish-Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve gjatë viteve 1945-1955”.


15 Nëntor 2017 - Të Miturit në Objektivin e Medias

Kolegji Universitar “Bedër” në bashkëpunim me Autoritetin e Medieve Audiovizive dhe Albanian Center for Public Communication zhvilluan një workshop me temë: “Të miturit në objektivin e medias.” Workshopi u organizua në ambientet e bibliotekës së KUB dhe në panel ishin drejtori i Drejtorisë së Programeve në AMA z. Arben Muka, korrespondentja e AFP-së (Agence France-Presse) në Shqipëri, znj. Briseida Mema, korrespondenti i “The Associated Press” z. L Lazar Semini, kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, z. Aleksandër Çipa, koordinatori për Marrëdhënie me Publikun dhe Median në Fondin e Ballkanit Perëndimor, z. Alban Tartari, si dhe pedagogu e shkrimtari i njohur Agron Tufa.

Gjatë workshopit, nën moderimin e përgjegjës të Departamentit të Komunikimit pranë KUB, Dr. Erlis Çela, u diskutua mbi situatën aktuale në media të trajtimit të figurës së të miturve dhe programacionin që i kushtohet kësaj moshe. Dr. Ramadan Çipuri dhe z. Alban Tartari ndanë me të pranishmit eksperiencat dhe rezultatet gjatë punimit të këtij projekti në workshop-et e organizuara në disa nga qytetet e vendit tonë me gazetarët e mediave lokale. Gjithashtu u diskutua edhe në lidhje me ligjet aktuale dhe rolin e organizatave për trajnimin dhe vendosjen e rregullatorëve për mediat në lidhje me pasqyrimin e figurës së fëmijëve dhe standardet etike në televizion dhe medie të tjera. Në përfundim të workshopit studentët ndanë edhe mendimet e tyre në lidhje me temën.

7 Janar 2018 - Marrëdhënia e Medias me Audiencat në Epokën Digjitale

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Kolegjin Universitar “Bedër” organizoi workshopin me temë “Marrëdhënia e Medias me Audiencat në Epokën Digjitale”. Për të diskutuar në panel morën pjesë Monika Stafa, kryetare e Këshillit të Ankesave në AMA (Autoriteti i Medieve Audiovizive); Thanas Goga, ekspert i matjes së audiencave dhe profesor në Universitetin e Tiranës; Aleksandër Çipa, kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë; Dr. Erlis Çela, përgjegjës i Departamentit të Shkencave të Komunikimit në Kolegjin Universitar “Bedër” Dr. Edlira Mali, lektore pranë të njëjtit departament, si dhe Doc. Dr. Ramadan Çipuri, lektor në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës.



Gjatë workshopit panelistët diskutuan në lidhje me audiencat në epokën digjitale, ndërtimin e një tregu mediatik, etikën dhe deontologjinë e mediave në Shqipëri si dhe për sfidat e gazetarit përballë multimedialitetit në ditët e sotme.

Një theks i veçantë u vu në mungesën e statistikave të besueshme për matjen e audiencës si dhe nevojën e studimeve mediatike që do t'i vinin në ndihmë AMA-s për të ndërmarrë hapa konkretë në lidhje me rregullimin e tregut mediatik.

16 Maj 2018 - Fake News, Problem i Medias apo i Demokracisë?

Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë Kolegjit Universitar "Bedër" organizoi workshopin me temë: "Fake News, problem i medias apo i demokracisë?"

Në këtë workshop morën pjesë Ambasadori i Prezencës së OSBE në Shqipëri, z. Bernd Borchardt, rektori i KUB Prof. dr. Ferdinand Gjana, përgjegjësi i Departamentit të Komunikimit pranë KUB, Dr. Erlis Çela, përgjegjësi i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, Prof.asoc.dr. Mark Marku, analisti dhe gazetari i njohur Lutfi Dervishi, kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, z. Aleksandër Çipa, drejtues dhe studiues së medias, përfaqësues së zyrave të PR-it, si Fatos Hakorja, Roland Zili, Roland Qafoku, Pandi Gjata, Llazar Semini, Elda Gjoka, Eva Kushova, Dr. Ramadan Çipuri si dhe pedagogë dhe studentë të komunikimit dhe gazetarisë.

Gjatë aktivitetit diskutuan dhe debatuan një numër i konsiderueshëm nga pjesëmarrësit, të cilët theksuan rëndësinë e organizimit të tryezave të tilla për të trajtuar një fenomen që ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të medias dhe audiencës, pasi diskutohet rreth mënyrave të zhvillimit të shëndetshëm të fjalës së lirë, duke u nisur edhe nga roli kritik që profesionistët e fushës së medias kanë, më tej diskutuesit ndalën në rrezikun që paraqet "fake news", në nevojën e rishikimit të parimeve të gazetarisë dhe duke theksuar se zgjidhja duhet të kërkohet në edukimin mediatik të audiencave, kontrollin e burimeve të lajmit përpara publikimit, si dhe një rikthim të vlerat deontologjike dhe profesionale të gazetarisë dhe më shumë liri për median.

Tregues të matshëm:


Të dhëna për kërkimin shkencor të personelit akademik, përgjegjës për programin e studimit

Tabela 25: Aktivitete shkencore personelit të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në 6 vitet e fundit


Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	71
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	2
3.	Numri i projekteve të zbatuara	2
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit	9
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	174
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	49
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	70
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	0

Tabela 26: Publikime dhe Projekte të Personelit (2014-2018)


Nr	Emër Mbiemër	Tema/Organizimi	Fusha Kërkimore	Konteksti i Publikimit	Vendi	Data
1.	Erlis Çela	Analysis of Critical Approaches on Interactive Communication Enabled by Social Media	Media dhe Komunikim	Media Sociale	Zagreb, Kroaci	2017
2.	Rahim Ombashi Genti Kruja	Del në Dritë një Poemë Tjetër Satirike e H. Ibrahim	Letërsi shqipe	Zani i Nalte - Zbulohen në arkiva dhe vlerësohen	Tiranë, AL	2017




		Dalliu		estetikisht		
3.	Rahim Ombashi	Metodat Digjitale në Arsimin e Lartë si Faktor i Ndërveprimit Real në Zhvillimin e Shpejtë Ekonomik	Edukim	Forumi i Pavarur i Rektorëve: <i>Ekonomia e dijes dhe tregu i arsimit të lartë në Shqipëri - Sugjerohen plotësime në kurrikulat gjegjëse</i>	Konferenca UETPRESS, Tiranë, AL	2017
4.	Rahim Ombashi	Njeriu i Përparimit Moral	Gjuhë Shqipe	Dalin në pah figura që kanë lënë trashëgimi e cila duhet njohur nga kërkuesit shkencorë.	Drita Islame – Tiranë, AL	Nëntor, 2017
5.	Rahim Ombashi Ramadan Shkodra	Institucioni i raporteve të letërsisë shqiptare me kulturën islame,	Letërsi Shqipe	Gjuhë dhe letërsi shqipe nëpërmjet qasjeve fetare	Prishtinë, Kosovë	2017
6.	Rahim Ombashi	Ndihmesa e Ligjërimit Human në Begatimin Shpirtëror të Shqipërisë së Pavarur"	Gjuhësi dhe Letërsi Shqipe	ISCON Konferenca Shkencore Ndërkombëtare në Studimet Islame,	KU Bedër, Tiranë, AL	05.04.2018
7.	Rahim Ombashi	Dituria Islame - Tribunë e Mendimit Fetar dhe Kombëtar	Gjuhësi dhe letërsi shqipe.	Binomi FE-ATDHE në themel të edukimit islam dhe të kulturës së tij	Prishtinë, Kosovë	2018
8.	Edlira Mali	Projekti "Një libër më shumë për Preshevën" për të ndërgjegjësuar publikun të kontribuojnë me libra jashtëshkollorë shqip dhe mjete shkollorë për fëmijët dhe të rinjtë në luginën e Preshevës	Media, Komunikim, Marketing, Menaxhim	Projekt studentor në kuadër të lëndës Konceptim dhe Menaxhim Fushatash me studentet e vitit të parë dhe të dytë Master Shkencor	K.U. Bedër Tiranë, AL Bujanoc, Serbi	Janar – Maj 2018
9.	Edlira Mali	Projekti "Vlerësimi i Markave nga Konsumatorët Shqiptarë"	Marketing, Komunikim	Projekt studentor në kuadër të lëndës Komunikimi dhe Menaxhimi i Identitetit Institucional të Markës me studentët t vitit të parë Master Shkencor	K.U. Bedër Tiranë, AL	Mars – Qershor 2018
10.	Ramadan Çipuri	Strategjitë e manipulimit përmes komunikimit politik dhe përdorimit të <i>spin doctors</i>	Media dhe komunikim	Thesis nr.1, 2017 Revistë shkencore (Përmbledhje e referimeve në konferencë)	Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë	2017
11.	Edlira Mali	Projekt "Një muze për At Gjergj Fishtë" për të ndërgjegjësuar aktorët e përfshirë në domosdoshmërinë e vlerësimit të figurës së At Gjergj Fishtës	Media dhe komunikim	Projekt studentor në kuadër të lëndës Konceptim dhe Menaxhim Fushatash me studentet e vitit të parë dhe të dytë Master Shkencor	KUB; Tirana, Albania Fishtë Lezhë	Tetor 2015- Mars 2016
12.	Ramadan Çipuri	Operatorët audiovizivë lokal dhe rajonal në Shqipëri; përpjekje ndaj një tranzicioni të tejzgjatur	Media dhe komunikim	Libër i Konferencës; Konferenca e dytë ndërkombëtare mbi studimet e medias dhe komunikimit: Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre	KUB; Tirana, Albania	15 dhjetor, 2016
13.	Edlira Mali	Projekt "Një fije floku për më shumë buzëqeshje" Për të ndërgjegjësuar në favor të dhurimeve për të ndihmuar fëmijët e sëmurë me kancer.	Media dhe komunikim	Projekt studentor në kuadër të lëndës Konceptim dhe Menaxhim Fushatash me studentet e vitit të parë dhe të dytë Master Shkencor	KUB; Tirana, Albania	Tetor 2015- Mars 2016
14.	Ramadan Çipuri	The News as a Product of the Media Industry; Its Promotion Through Sexist Elements	Media dhe komunikim	Libër i Konferencës ISBN 9788890916441 10 th International Congress on Social Sciences <i>European Center for Science Education and Research,</i>	Madrid, Spanjë	23 - 24 shtator 2016



				in cooperation with <i>Ciencia Política y de la Administración II, Universidad Complutense Madrid, MCSER - Mediterranean Center for Social and Educational Research</i>		
15.	Edlira Mali	Projekti studentor “Unë refuzoj të hesht. Bëje dhe ti. Voto!” për ndërgjegjësimin e të rinjve që votojnë për herë të parë që të marrin pjesë në votime.	Media dhe komunikim	Projekt studentor në kuadër të lëndës Komunikim Politik me studentet e vitit të tretë Bachelor në Shkenca Komunikimi	KUB; Tirana, Albania	Prill-Qershor 2015
16.	Briseida Mema	Nevoja e operatorëve lokalë audioviziv për burime njerëzore të specializuara	Media dhe komunikim	Libër i Konferencës; Konferenca e dytë ndërkombëtare mbi studimet e medias dhe komunikimit: Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre	Kolegji Universitar Bedër	15 dhjetor, 2016
17.	Edlira Mali	Projekt Studentor “Libri është i vetmi kopsht i mbjellur për të tjerët”	Media dhe komunikim	Projekt studentor në kuadër të lëndës Konceptim dhe Menaxhim Fushatash me studentet e vitit të parë dhe të dytë Master Shkencor	KUB; Tirana, Albania	Tetor 2014-Mars 2015
18.	Erlis Çela	Mediat lokale dhe ndikimi i tyre mbi angazhimin qytetar përmes medias sociale	Media dhe komunikim	Libër i Konferencës; Konferenca e dytë ndërkombëtare mbi studimet e medias dhe komunikimit: Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre	Kolegji Universitar Bedër, Tiranë, Shqipëri	15 dhjetor, 2016
19.	Erlis Çela	Personalizimi i komunikimit politik, roli i mediave sociale	Media dhe komunikim	Thesis nr.1, 2017 Revistë shkencore (Përmbledhje e referimeve në konferencë)	Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë	2017
20.	Agron Tufa	"Origjina e termave "përkthim"/ "me përkthye" dhe "shqipërim"	Komunikim kulturor – teori.	Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare “Pjetër Budi”	Revista "Pasqyra e t'rrëfyemit". E përkatërmuajsh me kritike, studimore, analitike, polemike,	2016, viti II, Nr. 4
21.	Agron Tufa	"Pjetër Budi dhe tradita përkthimore e tij".	Komunikim kulturor – teori.	Konferencë shkencore	Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare “Pjetër Budi”	22 tetor 2016
22.	Agron Tufa	"Diskursi metafizik përmes mitit dhe metamorfozave në romanin “Melusina të Balil Gjinit”"	Studim dhe kritika: teorite e komunikimit kulturor	Seminari X Ndërkombëtar i Albanologjisë në tematikën "Lokalja dhe universalja në kulturën shqiptare"	Universiteti Shtetëror i Tetovës	1 tetor 2016
23.	Agron Tufa	Roli misionar i revistës “Drita Islame” .	Komunikim masiv	Konferencë shkencore Ndërkombëtare 28 shkurt 2017	Publikim në revistën “Drita islame”	“Drita islame” Nr 3. 2017
24.	Agron Tufa	“Roli ambivalent i Mediave në njohjen e krimeve të komunizmit”	Komunikimi masiv	Konferenca e 5-të Ndërkombëtare e Shkencave Humane të Universitetit “Bedër”	Kolegji Universitar Bedër; Tiranë	24 maj 2017




25.	Agron Tufa	"Shtigjet kulturore që hapi Lumo Skëndo"	Komunikim letrar, kulturologji	Konferenca I Kombëtare e Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo"	Hotel Tirana International	8 qershor 2017
26.	Agron Tufa	"Kafsha apo Fantazma" – vëllim me poezi	Letërsi artistike	Panairi Kombëtar i Librit, 2017	shB "Onufri"	Tetor, 2016
27.	Agron Tufa	"Dueli", roman, ribotim	Letërsi artistike	Panairi Kombëtar i Librit, 2017	shB "Onufri"	Tetor, 2016
28.	Agron Tufa	"Letërsia dhe Procesi letrar në shek. XX. Pj. I", 440 faqe.	Teori dhe histori letërsie	Leksione ekskluzive për auditorët e specializuar universitarë	Sh.B "B&M"	Qershor, 2-17
29.	Agron Tufa	"Letërsia dhe Procesi letrar në shek. XX. Pj. II", 450 faqe.	Teori dhe histori letërsie	Leksione ekskluzive për auditorët e specializuar universitarë	Sh.B "B&M"	Qershor, 2-17
30.	Agron Tufa	"Origjina e termave "përkthim"/ "me përkthye" dhe "shqipërim"	Komunikim kulturor – teori.	Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare "Pjetër Budi"	Revista "Pasqyra e t'rrëfyemit". E përkatëmuajsh me kritike, studimore, analitike, polemike.	2016, viti II, Nr. 4
31.	Agron Tufa	"Pjetër Budi dhe tradita përkthimore e tij".	Komunikim kulturor – teori.	Konferencë shkencore	Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare "Pjetër Budi"	22 tetor 2016
32.	Ramadan Çipuri	Përballimi nga operatorët lokalë i kalimit në transmetimet dixhitale tokësore /	Media - Komunikim	Konferencë shkencore ndërkombëtare dhe botim në revistën shkencore të departamentit. Dixhitalizimi i transmetimeve televizive tokësore: Sfida, paradokse, shpresa (f.160-165)	Departamenti i gazetarisë dhe komunikimit, Universiteti i Tiranës, Tiranë/ Shqipëri	15 dhjetor, 2015
33.	Ramadan Çipuri	Përdorimi i i mazheve femërore në përmbajtjet mediatike; Diskutime etike	Media - Komunikim	Digital Worlds Conference	Ipek University Ankara, Turqi	07 – 08 prill, 2016
34.	Ramadan Çipuri	Trysnia e agjencive shtetërore ndaj medias dhe ndikimi në prodhimin e informacionit./	Media - Komunikim	Beder Journal of Humanities Issue 5 (Special Issue) f.110-125 ISSN 2306-6083	Kolegji Universitar Beder; Tiranë	Spring, 2016
35.	Ramadan Çipuri	Vetëcensura e gazetarëve shqiptarë, si pasojë e kontrollit politik të medias	Media - Komunikim	Journal of Communications Faculty, Istanbul University. Issue 50	Communication Faculty Istanbul University, Stamboll/Turqi	Qershor, 2016
36.	Erlis Çela	The role of social media for the increasement of the audiences' interactivity level	Media- Komunikim	Digital Worlds Conference Ipek University	Ankara	2016
37.	Erlis Çela	Social Media Usage in Albanian Market	Media- Komunikim	European Journal of Economics and Business Studies ISSN 2411-9571 (Print) ISSN 2411-4073 (online)	Londër	2015
38.	Erlis Çela	Social Media as a New Form of Public Sphere	Media - Komunikim	6th International Conference on Social Sciences Istanbul, 11-12 September 2015 ISBN 9788890916335	Stamboll/Turqi	2015
39.	Erlis Çela	Citizen Journalism - Challenges for Albanian Media	Media - Komunikim	European Journal of Interdisciplinary Studies ISSN 2411-958X (Print) ISSN 2411-4138 (Online)	Londër	2015
40.	Briseida Mema	Social networks as a source of conflict within the family		International Conference on Family Studies, Catholic University Our Lady of Good Counsel	Tiranë	Maj 2016
41.	Rahim Ombashi	An approach to study of	Komunikim	1-st International	Stamboll,	Tetor 2014



		tesavvuf in albanian literature,	kulturor kontekstual dhe lokal	Congress of Turkish Culture, Tetor, Turkey 2014. Electronic edition. (A. Balaban, 3B. Caglayan, R. Ombashi).	Turqi	
42.	Rahim Ombashi	An approach to study of tesavvuf in albanian literature	Komunikim kulturor kontekstual dhe lokal	1-st International Congress of Turkish Culture, Tetor, Turkey 2014. Electronic edition. (A. Balaban, B. Caglayan, R. Ombashi).	Stamboll, Turqi	Tetor 2014
43.	Rahim Ombashi	An existential approach the celebration of summer day, udek,	Komunikim kulturor kontekstual dhe lokal	3rd International Conference on Language and Literature "Turkish in Europe", Tetor 30-November 01, 2014, Tirana.	Tiranë	Nëntor 2014
44.	Rahim Ombashi	Ideological marketing as interpretation propaganda on poetry path of national literature,	Komunikim kulturor kontekstual dhe lokal	First International Conference on Communication and Media Studies,	Tiranë	March 26-27, 2015
45.	Rahim Ombashi	Echos of gallipoli war in Albania	Komunikim kulturor kontekstual dhe lokal	International Congress on the Gallipoli Battles on the Centenary,	Çanakkale, Turqi	May 20-25, 2015
46.	Rahim Ombashi	Fara e lashtë e letërsisë shqipe	Komunikim kulturor kontekstual dhe lokal	International Conference on Humanities ICH 2015.	Tiranë	29-30 May 2015.
47.	Rahim Ombashi	Nga art i importuar në letërsi kombëtare	Komunikim kulturor kontekstual dhe lokal	Islamic - oriental heritage in Balkan	Prishtinë	10-11.06. 2015
48.	Rahim Ombashi	Duke dëgjuar letrën e fundit	Komunikim kulturor kontekstual dhe lokal	Tempulli 18	Korçë	2015
49.	Rahim Ombashi	Tesavvuf dhe palimpsest	Studim dhe mesazh	ISBN 978-9928-181-244 Botimet Kumi	Tiranë	2014
50.	Ramadan Çipuri	Diversiteti kulturor përmes telenovelave në TV Klan dhe TV Top Channel	Media - Komunikim	Revista shkencore: Studime albanologjike; Diversiteti kulturor në media. F.96-106	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë; Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit; Tiranë, Shqipëri	Dhjetor, 2014
51.	Ramadan Çipuri	Arsyet e terrenit vetëcensurues për gazetarët	Media - Komunikim	Revistë kërkimore ndërkombëtare: Thesis F.91-108	Institucioni i Arsimit të lartë AAB; Prishtinë, Kosovë	Viti 4, Nr.1; Pranverë 2015
52.	Ramadan Çipuri	Trysnia e agjencive shtetërore ndaj medias dhe ndikimi në prodhimin e informacionit	Media - Komunikim	Konferenca Ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim: Industria e medias, trendet, dinamikat dhe sfidat. F. 499-516	KUB; Departamenti i Shkencave të komunikimit; Tiranë, Shqipëri	26-27 mars, 2015
53.	Ramadan Çipuri	Prania dhe ndikimi i elementëve propagandistik në mjetet e komunikimit masiv	Media - Komunikim	Konferenca e katërt ndërkombëtare në shkenca humane: "Identiteti, kultura dhe komunikimi" Botimi në proces	KUB; Departamenti i Shkencave të komunikimit; Tiranë, Shqipëri	29-30 maj, 2015
54.	Ramadan Çipuri	Gazetari shqiptar mes standardeve profesionale dhe presioneve të jashtme	Media - Komunikim	Konferencë ndërkombëtare mbi studimet e medias dhe komunikimit Botimi në proces	Kolegji AAB, Fakulteti i Komunikimit Masiv, Departamenti i	30 maj 2015


					Gazetarisë dhe Komunikimit	
55.	Briseida Mema	Dilemat e informimit në epokën numerike-rasti shqiptar.	Media	Konferencë Ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim: "Industria e medias, trendet, dinamika dhe sfidat"	Kolegji Universitar "Bedër"	Mars 2015
56.	Briseida Mema	Albania-Balkans-health-abortion-gender	Zhvillimi demografik	Studim për Institutin francez të kërkimeve për zhvillimin demografik	Paris	Prill 2015
57.	Agron Tufa	Mbi promovimin e nocionit "Kombi kosovar"	Identiteti kulturor	Prezantim në konferencën e 4rt Ndërkombëtare për Shkencat Humane "Identitet, Kulturë dhe Komunikim"	Kolegji Universitar Bedër; Tirana, Albania	29-30 Maj 2015
58.	Edlira Mali	Komunikimi organizativ në biznese dhe institucione	Komunikimi organizativ	Prezantim në konferencën e 4rt Ndërkombëtare për Shkencat Humane "Identitet, Kulturë dhe Komunikim"	Kolegji Universitar Bedër; Tirana, Albania	29-30 Maj 2015
59.	Aleksandër Çipa	Identiteti i munguar i shtypit shqiptar	Media dhe komunikim	Prezantim në konferencën e 4rt Ndërkombëtare për Shkencat Humane "Identitet, Kulturë Komunikim"	Kolegji Universitar Bedër; Tirana, Albania	29-30 Maj 2015
60.	Emirjon Senja	Evoluimi i formave të aksesit në lajmin online; Klikimet nëpërmjet aparateve celulare	Media dhe komunikim	Konferencë Ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim: "Industria e medias, trendet, dinamika dhe sfidat"	KUB; Departamenti i Shkencave të komunikimit; Tiranë, AL	Mars, 2015
61.	Emirjon Senja	Zhvillimet teknologjike si shkak i evoluimit të lajmit në median online të Shqipërisë	Media dhe komunikim	Prezantim në konferencën e 4rt Ndërkombëtare për Shkencat Humane "Identitet, Kulturë dhe Komunikim"	KUB; Departamenti i Shkencave të komunikimit; Tiranë, AL	Maj, 2015
62.	Erlis Çela	Media shqiptare online dhe modelet e funksionimit	Mediat e reja	Konferenca ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim	Prishtinë	30.05.2015
63.	Erlis Çela	Mediat sociale dhe risia e aplikacioneve si mënyra të komunikimit publik dhe politik	Mediat sociale, Komunikim politik	Konferenca Ndërkombëtare në Shkencat Humane	Tiranë	29.05.2015
64.	Erlis Çela	Media sociale si një burim informacioni për median tradicionale, marrëdhënia ndërvepruese mes tyre.	Mediat e reja, audiencia	Konferenca ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim	Tiranë	25.04.2015
65.	Erlis Çela	Audienat e reja, ndryshimi i raportit me procesin e prodhimit dhe konsumimit të lajmit	Mediat sociale	Konferenca shkencore ndërkombëtare "Diteve të Studimeve Shqiptare"	Tiranë	27.03.2015
66.	Ilda Shytaj	Trendet e Arsimit të Lartë në Reklamim, Rekrutim dhe Teknologji	Arsimi i Lartë	Prezantim në Konferencë	KUB; Tirana, Albania	26 Mars 2015
67.	Ilda Shytaj	Trendet më të reja të markës në Arsimin e Lartë: Një Sugjerim për Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri	Arsimi i Lartë	Prezantim në Konferencë	Universiteti Fatih/ Turqi	5 Qershor 2015
68.	Ilda Shytaj	Një qasje socio-psikologjike e brendësimit të Islamit: Analizë në kuadrin e teorisë dhe praktikës në jetës përditshme	Komunikim Fetar	Prezantim në Konferencë	KUB; Tirana, Albania	29 Maj 2015
69.	Rudi Dunga	Ndikimi i Rrjeteve Sociale në Median Online	Mediat e Reja	Konferencë shkencore	KUB; Tirana, Albania	26 mars 2015



70.	Rudi Dunga	Ndikimi i Rrjeteve Sociale dhe Teknologjisë tek të Rinjtë	Mediat e Reja	Konferencë shkencore	KUB; Tirana, Albania	29 maj 2015
71.	Tufa, Agron	Roli i Mediave për njohjen e Krimeve të Komunizmit	Komunikim	Referues / Autor	3rd International Conference on Humanities: Socio-Economic Dimensions of Peace Building, KUB, Tirana, AL	2014
